

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT  
SEKSIONI I TRETË

**ÇËSHITJA NIKËHASANI KUNDËR SHQIPËRISË**  
(*Kërkesa nr. 58997/18*)

VENDIM

Neni 8 – Jeta private – Shkarkim i justifikuar i prokurores nga detyra për shkak të dyshimeve serioze, në lidhje me përshtatshmërinë e financave të saj mbështetur në konstatimet e procesit të rivlerësimit (*vetting-ut*) – Ndalim i përhershëm proporcional për të rihyrë në sistemin e drejtësisë për shkelje të rëndë etike

STRASBURG  
13 dhjetor 2022

**I FORMËS SË PRERË**  
22.5.2023

*Ky vendim është bërë i formës së prerë sipas nenit 44 § 2 të Konventës. Ai mund të bëhet objekt i një rishikimi redaktues.*

**Në çështjen Nikëhasani kundër Shqipërisë,**

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Dhomë e përbërë nga:

Pere Pastor Vilanova, *kryetar*,  
Georgios A. Serghides,  
Jolien Schukking,  
Darian Pavli,  
Peeter Roosma,  
Ioannis Ktistakis,  
Andreas Zünd, *gjyqtarë*  
dhe Milan Blaško, *sekretar i Seksionit*;

Duke pasur në konsideratë:

kërkesën (nr. 58997/18) kundër Republikës së Shqipërisë paraqitur pranë Gjykatës, në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) nga një shtetase shqiptare, znj. Besa Nikëhasani (“ankuesja”), më 17 dhjetor 2018;

vendimin për të njoftuar Qeverinë shqiptare (“Qeveria”) për ankesën dhe për t’i dhënë prioritet, sipas Rregullit 41 të Rregullores së Gjykatës;

komentet e palëve të treta marrë nga Res Publica dhe Komisioni Evropian, të cilave iu ishte dhënë leja nga kryetari i Seksionit për të ndërhyrë në procedurën me shkrim (neni 36 § 2 i Konventës dhe rregulli 44 § 3 i Rregullores së Gjykatës);

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura më datë 22 nëntor 2022;

Shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë.

HYRJE

1. Çështja ka të bëjë me procedurat e rivlerësimit në lidhje me kërkuesen, e cila në atë periudhë ishte një prokurore në detyrë, në mbështetje të ligjit nr. 84 të datës 30 gusht 2016 (“Ligji për rivlerësimin”). Procedurat rezultuan në shkarkimin e saj nga detyra.

#### FAKTET

2. Kërkuesja ka lindur në vitin 1971 dhe jeton në Tiranë. Ajo u përfaqësua nga z. A. Saccucci dhe znj. G. Borgna, avokatë të cilët e ushtrojnë profesionin në Romë.

3. Qeveria u përfaqësua fillimisht nga agjenti i saj z. A. Metani, dhe në vijim, nga znj. J. Mansaku, znj. E. Muçaj dhe z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit.

4. Faktet e çështjes mund të përmbliidhen si më poshtë.

5. Kërkuesja u emërua në pozicionin e prokurores në vitin 1993. Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Deklarimin e Pasurisë në vitin 2003 (shih paragrafin 24 më poshtë), ajo filloi të dorëzonte deklaratat vjetore për pasurinë pranë Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave (“ILDKPKI”).

#### I. PROCESI I RIVLERËSIMIT (VETTING-ut) NË SHQIPËRI

6. Në vitin 2016, Shqipëria ndërmori reforma të thella në sistemin e drejtësisë, të cilat çuan në ndryshime në Kushtetutë dhe në hyrjen në fuqi të një sërë statutesh, në lidhje me to, midis gjërave të tjera, rivlerësimin e të gjithë prokurorëve në detyrë (në vijim referuar si “procesi i *vetting*-ut”) (shih *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, nr. 15227/19, §§ 4–7, 9 shkurt 2021). Procesi i *vetting*-ut do të kryhej nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (“KPK”) në shkallë të parë dhe – në rastin e një apelimi – nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim referuar si “KPA”) pranë Gjykatës Kushtetuese (së bashku referuar si “organet e *vetting*-ut”). Organet e *vetting*-ut do të duhej të rivlerësonin çdo prokuror në detyrë mbi bazën e tri kriterëve: i. vlerësimi i pasurisë; ii. kontrolli i figurës me synimin për të konstatuar ndonjë lidhje të mundshme me krimin e organizuar; dhe iii. vlerësim i aftësive profesionale. Në përfundim të secilit grup të procedurave të rivlerësimit, organet e *vetting*-ut do të duhej të jepnin vendime të arsyetuara, duke konfirmuar në detyrë ose pezulluar ose shkarkuar nga detyra personin e rivlerësuar.

#### II. PROCEDURAT PËR KËRKUESEN

##### A. Në KPK

7. Në periudhën kur filloi procesi i *vetting*-ut, kërkuesja ushtronte profesionin si prokurore në prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër. Në janar 2017, ajo paraqiti deklaratat për *vetting*-un të parashikuara në ligj. Ajo deklaronte, *inter alia*, pasuritë kryesore si e më poshtë:

a) një apartament me një sipërfaqe prej 144 m<sup>2</sup> në Tiranë, blerë në vitin 2009 për 90,000 euro (EUR) me kursimet familjare ndër vite; të ardhurat nga shitja e disa trojeve në vitin 2008 dhe 2010; dhe një hua bankare prej 7.1 milionë lekësh (ALL), e ekuivalentuar në euro në vlerën prej 50,000 eurosh;

b) një apartament me një sipërfaqe prej 76 m<sup>2</sup> në Lezhë përftuar sipas një kontrate të vitit 2010 nga një kompani ndërtimi, sipas një marrëveshjeje, pas prishjes së një tjetër banese në Lezhë përftuar në vitin 1998 në pronësi të familjes; dhe 3,000 euro nga kursimet familjare në vitin 2009;

c) një njësi tregtare shërbimi me një sipërfaqe prej 150 m<sup>2</sup> në Lezhë përftuar në vitin 2011 sipas marrëveshjes përmendur më sipër; dhe

d) një automjet Toyota blerë për 19,500 euro në vitin 2016, ku 12,000 euro ishin marrë me anë të një kontrate huamarrjeje nga një individ privat, A. M.; 4,000 euro marrë nga shitja e një automjeti tjetër sipas një kontrate të vitit 2016; dhe nga kursimet familjare në vitet 2015 dhe 2016.

8. Për shkak të kandidaturës së kërkueses në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, organi drejtues i Prokurorisë, ajo u shtua në listën e personave që do të rivlerësoheshin me prioritet. Më 30 nëntor 2017, u hodh shorti pranë KPK-së për trupin gjykues që do të rivlerësonte kërkuesen.

9. ILDKPKI-ja paraqiti një raport pranë KPK-së në lidhje me vlerësimin e pasurisë (shih paragrafin 28 më poshtë), duke arritur në përfundimin se deklarata e kërkueses ishte e saktë, në përputhje me ligjin, e mbështetur me burime financiare të ligjshme dhe se nuk kishte asnjë konflikt interesi, nuk kishte mungesë të burimeve të ligjshme financiare për justifikimin e pasurisë, nuk kishte pasuri të fshehura dhe asnjë deklaratë false.

10. KPK-ja vijoi me një hetim të detajuar administrativ në lidhje me njërin prej tri kritereve të rivlerësimit, më konkretisht, me vlerësimin e pasurisë, në lidhje me, *inter alia*, prova të tjera të tilla si deklaratat e mëparshme vjetore të kërkueses. Më 15 dhjetor 2017, KPK-ja i dërgoi kërkueses pyetësorin e parë në vijim të deklaratave të bëra, me anë të së cilit kërkonte sqarime në lidhje me pasuri të caktuara dhe kostot e arsimimit të fëmijëve të saj. Kërkuësja paraqiti informacionet shtesë brenda afatit të parashikuar. Më 31 janar 2018, KPK-ja dërgoi një pyetësor të dytë në vijim të deklaratave të bëra, me anë të së cilit kërkueses i kërkohet, *inter alia*: i. të paraqiste kontratën sipas së cilës ishte përfutur pronësia e apartamentit në Lezhë, me një përcaktim të qartë të vitit të blerjes, të sipërfaqes dhe çmimit të blerjes; dokumentacion provues në lidhje me të ardhurat e përdorura për përfutimin e tij; aktin noterial, sipas së cilit kërkuësja kishte përfutur nga shuma prej 25,000 eurosh marrë prej kompanisë së ndërtimit; dhe iii. të paraqiste informacion për datën e saktë në të cilën ajo kishte marrë të ardhurat nga shitja e trojeve nga vjehrra e saj të cilat ishin përdorur për të njëjtën blerje. Kërkuësja u përgjigj më 8 shkurt 2018 dhe paraqiti disa dokumente. Më 13 shkurt 2018, KPK-ja dërgoi një pyetësor të tretë në vijim të deklaratave të bëra, me anë të së cilit kërkoheshin informacione shtesë. Kërkuësja u përgjigj më 20 shkurt 2018.

11. Më 13 mars 2018, KPK-ja mbylli hetimin administrativ. Më 14 mars 2018, KPK-ja informoi kërkuesen për mbylljen e hetimeve mbështetur vetëm në vlerësimin e pasurisë dhe e njohu atë me gjetjet paraprake së bashku me raportin e ILDKPKI-së dhe dokumente të tjera nga dosja e çështjes.

12. Gjetjet paraprake të KPK-së ishin si më poshtë:

a) Në lidhje me apartamentin në Tiranë, kërkuësja nuk kishte listuar dy garazhe në deklarimin e saj për *vetting*-un dhe nuk kishte paraqitur prova për burimin e shumës prej 752,880 lekësh të përdorur për të paguar një pjesë të çmimit të blerjes, dhe se kishte mjaftueshëm kursime për të paguar pjesën tjetër të çmimit të blerjes.

b) Kërkuësja kishte pasur të ardhura të pamjaftueshme për të përfutur apartamentin dhe njësinë e shërbimeve në Lezhë, dhe për të justifikuar blerjen e automjetit në vitin 2016.

KPK-ja e kaloi barrën e provës të kërkuësja në lidhje me këto pasuri dhe problematika, dhe i dha asaj një afat prej njëzet ditësh për të paraqitur argumentet dhe dokumentet provuese si përgjigje të kësaj kërkesë.

13. Më 3 prill 2018, kërkuësja paraqiti parashtrimet e saj, duke adresuar problematikën e theksuar nga KPK-ja dhe duke paraqitur dokumente në mbështetje të argumenteve të saj. Ajo shpjegoi se garazhet nuk ishin përfshirë në deklaratën e *vetting*-ut, për shkak të një gabimi, dhe se nuk kishte pasur asnjë qëllim që të fshiheshin ato pasuri, siç edhe provohej qartazi nga fakti se ajo kishte paraqitur një kopje të plotë të marrëveshjes së blerjes në të cilën përmendeshin shprehimisht garazhet. Ajo sqaronte se shumica e çmimit të blerjes ishte shlyer me anë të kredisë bankare dhe pjesa tjetër me kursimet, duke përfshirë edhe të ardhurat nga shitja e trojeve nën pronësinë e vjehrrës së saj. Ajo shpjegonte se ato të ardhura ishin përfutur nga vjehrra e saj në vitin 2008. Për sa u përket pronave në Lezhë, kërkuësja shpjegonte se familja e saj kishte blerë një apartament në qytet në vitin 1998. Për shkak të problematikave me lejen e ndërtimit, ndërtesa ishte shembur. Kompania e ndërtimit e kishte kompensuar familjen e saj me 25,000 euro, të cilat më pas ishin përdorur për të blerë një apartament tjetër, si edhe me kalimin në pronësinë e saj të njësisë së shërbimit. Në lidhje me blerjen e automjetit në vitin 2016, kërkuësja shpjegonte se ai ishte paguar me kursimet dhe me një hua nga shoku i bashkëshortit, A.M.

14. Më 10 prill 2018, KPK-ja njoftoi kërkuesen se seanca ishte planifikuar për t'u mbajtur më 17 prill 2018. Në seancë, ajo afroi shpjegime të tjera, në lidhje me çështjet e ngritura nga KPK-ja.

15. Me anë të vendimit nr. 15, të datës 20 prill 2018, KPK-ja e shkarkoi kërkuesen nga detyra, pasi në total kishte deklaruar pasuri me vlerë dyfish më të madhe sesa të ardhurat e saj legjitime. Sipas KPK-së, ajo kishte bërë deklarime të pasakta në deklaratat e saj vjetore dhe në deklaratën e saj për *vetting*-un; nuk kishte provuar burimet e ligjshme për të justifikuar pasuri të caktuara, duke u përpjekur t'i justifikonte ato duke u kthyer pas në kohë me anë të dokumenteve të marra kohët e fundit; dhe kishte fshehur pasuri në shumën të vogla. KPK-ja paraqiti gjetjet e mëposhtme.

a) Kërkuesja kishte paraqitur një kopje të plotë të marrëveshjes së blerjes për apartamentin në Tiranë, por, sidoqoftë, ajo nuk kishte listuar dy garazhet në deklaratën e saj të *vetting*-ut. Ajo nuk kishte paraqitur prova se në vitin 2008, vjehrra i kishte dhënë asaj dhe bashkëshortit të saj shumën prej 752,880 lekësh, nga të ardhurat e shitjes së dy trojeve, shumë e cila më pas u përdor për të paguar një pjesë të çmimit të blerjes së apartamentit. Në këtë mënyrë, ajo kishte bërë një deklaratë false. Sipas përlogaritjes së shpenzimeve për periudhën 2004-11 bërë nga familja e saj (duke përfshirë tre fëmijë dhe, ndoshta, vjehrrën që jetonte me familjen) dhe duke pasur parasysh shpenzime të tjera, si udhëtimi drejt vendit të saj të punë në Shkodër, ekzistonin "dyshime të arsyeshme", se shumën prej 108,750 lekësh në muaj për shpenzimet familjare (siç pohohej nga kërkuesja) ishte mjaftueshëm, dhe kishte edhe më pak mundësi që kërkuesja të mund të kishte mbledhur kursime në vlerën prej 2,019,700 lekësh për të paguar pjesën e mbetur të çmimit të blerjes.

b) Në lidhje me apartamentin dhe njësinë e shërbimit në Lezhë, edhe pse kërkuesja kishte deklaruar 25,000 euro në deklaratën e saj vjetor, fakti ishte se ajo nuk kishte dokumente që të provonte (në përputhje me parashikimet e Kodit Civil) pronësinë e apartamentit i cili ishte shembur, dhe për të cilin, më pas, ajo kishte përfutur ato prona. Marrëveshja noteriale e nënshkruar në vitin 2011 midis kompanisë së ndërtimit dhe bashkëshortit të kërkueses, e cila parashikonte kushtet për kompensimin e apartamentit të shembur ishte e pamjaftueshme për të provuar se ajo kishte pasur të drejta pronësie ndaj tij. Gjithashtu, theksohej se ajo nuk e kishte deklaruar atë apartament të parë në deklaratën e saj të parë vjetore, gjë e cila ishte e pafalshme për një prokurore me dhjetë vjet në detyrë në atë periudhë; se ajo kishte paraqitur informacione që nuk përputheshin me njëri-tjetrin në vitin 2004 dhe në deklaratën e *vetting*-ut në vitin 2017 për vitin e blerjes së apartamentit, vlerën e tij, sipërfaqen dhe burimet e të ardhurave të përdorura për përfundimin e tij; dhe se nuk ishin deklaruar 2,100,000 lekë bë lidhje me atë apartament.

c) Pasi automjeti tip Toyota ishte importuar në Shqipëri me vlerën e deklaruar 23,900 euro dhe pasi ishte paguar taksa përkatëse për këtë shumë, dy javë më pas, në gusht 2016, bashkëshorti i kërkueses kishte paguar 19,500 euro për ta blerë atë. Në mungesë të shpjegimeve bindëse, ky mund të konsiderohet si transaksion i pajustificuar. Shumën prej 4,000 eurosh nga shitja e makinës së vjetër u përvetësua vetëm në shtatorin e vitit 2016. A.M. kishte bërë deklarata kontradiktore, në lidhje me origjinën e shumës prej 12,000 eurosh që ai i kishte dhënë hua bashkëshortit të kërkueses, dhe sipas të dhënave të disponueshme, nuk kishte pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për ta bërë një gjë të tillë.

## **B. Përpara KPA-së**

16. Më 4 qershor 2018, kërkuesja apeloi pranë KPA-së, duke argumentuar si më poshtë.

a) KPK-ja nuk e ngriti çështjen se kërkuesja kishte deklaruar pasuri me vlerë dy herë më të madhe sesa të ardhurat e saj të ligjshme në asnjë fazë të procedurave, për këtë arsye vendimi përfundimtar i KPK-së e kishte zënë në befasi kërkuesen. Ajo pretendoi për një shkelje të të drejtave të saj për gjykim të drejtë duke u mbështetur tek argumenti se nuk kishte pasur mundësi të mbronte veten për atë problematik, gjë e cila ishte vendimtare për rezultatin e çështjes.

b) KPK-ja nuk i kishte marrë në konsideratë gjetjet e ILDKPKI-së dhe kishte realizuar vlerësimin e vet ekonomik dhe financiar për pasurinë e saj pa pasur ekspertizën e nevojshme për ta bërë një gjë të tillë. Përfundimet e KPK-së për këtë aspekt ishin të paargumentuara.

c) Shkarkimi i saj nga detyra ishte qartazi joproporcional, duke pasur parasysh mungesën e çfarëdo qëllimi për të fshehur pasurinë dhe problematikën e vogël në deklaratën e saj të *vetting*-ut.

d) Gjetjet e KPK-së në lidhje me dhuratën nga vjehrra e saj ishin të gabuara. Marrëveshja e shitjeve të trojeve konfirmonin se vjehrra e saj i kishte marrë ato para në vitin 2008. Më pas, ato para i ishin dhënë kërkueses dhe bashkëshortit të saj, siç provohet edhe nga fakti se ajo i kishte deklaruar paratë në deklaratat e saj vjetore për pasurinë nga viti 2008 e në vijim.

e) Pronat në Lezhë ishin përfutur pas marrëveshjes së arritur me kompaninë e ndërtimit për apartamentin e shembur, që më herët kishte qenë në pronësinë e saj. Në vitin 2010, bashkëshorti i saj dhe kompania kishin lidhur një marrëveshje paraprake, sipas së cilës ajo kishte marrë një kompensim prej 25,000 eurosh. Ajo marrëveshje ishte formalizuar në një dokument me shkrim në vitin 2011, i cili njihte pagesën e shumës së sipërpërmendur dhe shtonte, si kompensim të mëtejshëm, pronësinë e njësisë së shërbimit.

f) KPK-ja kishte vendosur një barrë të paarsyeshme ndaj saj, sipas së cilës ajo duhej të provonte se një person tjetër, A.M., kishte pasur të ardhura të ligjshme për t'i dhënë asaj hua një shumë të vogël për blerjen e automjetit të përdorur.

17. Kërkuesja paraqiti prova shtesë në mbështetje të pretendimeve të saj. Rezulton se ajo paraqiti një kërkesë që në dosjen e saj të pranoheshin prova dokumentare në lidhje me të ardhurat nga shitja e dy trojeve dhe pronësinë e apartamentit të shembur në Lezhë. Gjithashtu, ajo paraqiti edhe një raport të përgatitur nga eksperti, në të cilin përlllogariteshin të ardhurat dhe shpenzimet e saj ndër vite, me qëllim përgënjeshtrimin e gjetjeve të KPK-së.

18. Me anë të një vendimi procedural, KPA e rrëzoi kërkesën e saj për të pranuar prova të reja, pasi nuk ishte paraqitur asnjë arsye e përshtatshme për faktin se përse ajo nuk i kishte paraqitur këto prova më herët pranë KPK-së, dhe në çdo rast, pas një vlerësimi paraprak, dukej se ishte e pavend që të merrej një vendim për apelim. Sipas kërkueses, ajo nuk ishte njoftuar për atë vendim procedural gjatë procedurave në apel.

19. Kërkuesja dorëzoi parashtrime të tjera, më 20 dhe 28 qershor 2018. Më 7 shtator 2018, ajo paraqiti të dhëna të tjera, ku përshihej një deklaratë e noterizuar nga A.M. dhe një faturë bankare, me qëllimin për të provuar se ajo e kishte shlyer pjesën substanciale të asaj huaje. Rezulton se KPA nuk mori një vendim, në lidhje me kërkesën e saj në atë periudhë.

20. Me anë të vendimit nr. 6, të datës 12 shtator 2018, trupi gjykues i KPA-së la në fuqi vendimin e datës 20 prill 2018.

a) KPA-ja deklaroi se i kishte hedhur poshtë kërkesat e kërkueses për të paraqitur prova shtesë. KPA-ja rrëzoi pretendimin e saj se nuk ishte njoftuar nga KPK për “akuzën” se kishte pasuri në një vlerë dyfish më të madhe sesa të ardhurat e saj të ligjshme, sepse ai përfundim ishte pasojë e parashikueshme e çështjeve të përcaktuara si problematike në përfundim të hetimit administrativ dhe se ai përfundim mund të arrihej si rezultat përfundimtar i vlerësimit të pasurisë. KPA-ja u shpreh se vendimi i KPK-së për të mos marrë në konsideratë gjetjet e ILDKPKI-së dhe të mbështetej në perceptimin e vet të provave ishte legjitim. Në vijim, KPA-ja gjykonte se mospërputhjet ose mungesat e rëndësishme në deklaratën e *vetting*-ut mund të justifikonin shkarkimin nga detyra edhe në mungesë të elementit subjektiv të përgjegjësisë, dhe se vendimi i KPK-së për të mbyllur hetimin paraprak vetëm për pasurinë ishte legjitim.

b) KPA-ja la në fuqi përfundimet e arritura nga KPK-ja për meritat, se: deklarata e *vetting*-ut e kërkueses nuk ishte e saktë dhe se ajo kishte bërë gabime dhe pasaktësi në mënyrë të përsëritur në deklaratat e saj; se burimet financiare të ligjshme ishin të pamjaftueshme për të justifikuar përfundimin e

pronave të mëdha; se mungonin burimet financiare të ligjshme për pasuritë në pronësinë e saj dhe mungonte dokumentacioni ligjor në lidhje me pronësinë e burimeve të pretenduara; dhe se ajo kishte fshehur pasurinë dhe kishte bërë deklaratë të rreme.

c) KPA-ja la në fuqi konstatimin e KPK-së se pasuria e përgjithshme ishte dy herë më e madhe sesa të ardhurat e vlerësuara si të ligjshme mbështetur në të gjitha shpjegimet dhe provat e paraqitura nga kërkuesja, dhe të gjitha të dhënat e mbledhura gjatë hetimit dhe të bëra me dije kërkueses. Ai përfundim ishte pasoja logjike e arsytimit në lidhje me çdo pasuri, dhe e krahasimit midis shumës së pasurisë së akumuluar në vite dhe të deklaruar në deklaratën e *vetting*-ut në vitin 2017 dhe në vlerësimin e ligjshmërisë së burimeve të të ardhurave. Parashikimet e zbatueshme kushtetuese dhe të tjera nuk e lidhnin pamjaftueshmërinë e deklaratës me elementet subjektive, me qëllimin për të fshehur pasurinë. Kërkuesja duhej të shpjegonte në mënyrë bindëse burimin legjitim të pasurisë dhe të ardhurave, dhe nuk mund të fshihte, apo të paraqiste në mënyrë të pasaktë, pasuritë e zotëruara, e fituara dhe të përdorura. Sipas nenit 4 të Ligjit për Rivlerësimin, vendimi mund të bëhej mbështetur në një ose më shumë kritere ose në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kritereve. Pas nisjes së hetimeve për të tria kriteret, dhe pas përfundimit të pjesës për kriterin e pasurisë, KPK-ja mori në konsideratë vlerën provuese të të dhënave të mbledhura, dhe vendosi ta kufizonte vlerësimin vetëm në atë kriter. KPK-ja e kishte kaluar barrën e provës të kërkuesja, e cila ishte (vënë) në dijeni se ajo kjo barrë kishte të bënte vetëm me vlerësimin e pasurisë. Parashikimet kushtetuese dhe parashikime të tjera që kanë të bëjnë me çështjen parashikojnë masa disiplinore mbështetur qoftë edhe në vetëm një kriter.

21. Trupi gjykues i KPA-së bëri konstatimet e mëposhtme në lidhje me pasurinë kryesore.

a) Apartamenti në Tiranë ishte deklaruar si i blerë për shumën e ekuivalentuar prej 90,000 eurosh (12,345,300 lekë), paguar me kursimet familjare gjatë viteve, të ardhurat nga shitja e trojeve dhe një kredi bankare ekuivalente në vlerën 50,000 euro (7,100,000 lekë). Në një kontratë të muajit dhjetor 2009, lidhur nga bashkëshorti i kërkueses, 80,000 euro ishte caktuar si çmimi për atë apartament dhe 10,000 euro si çmimi për dy garazhet. Në deklaratën e saj të vitit 2009, kërkuesja kishte deklaruar vetëm apartamentin. Në vitin 2010, ajo i kishte deklaruar të dy për shumën në total prej 90,000 eurosh. Sipas të dhënave nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, dy garazhet ishin regjistruar si prona të veçanta. Deklarata e pasurisë kërkonte një përshkrim të detajuar të të gjithë pasurisë së akumuluar gjatë viteve deri në datën e deklarimit. Në këtë mënyrë, KPK-ja, me të drejtë, kishte gjykuar se kërkuesja nuk kishte qenë e saktë në deklaratën e saj të *vetting*-ut në lidhje me dy garazhet.

Për sa u përket të ardhurave nga shitjet e dy trojeve të vjehrrës së saj në vitin 2008 për shumën 376,400 secili, me anë të një akti noterial dhurate të datës 22 gusht 2013, ajo ia kishte dhënë këto të ardhura djalit të saj, bashkëshortit të kërkueses. Kërkuesja nuk kishte paraqitur asnjë provë (tjetër) dokumentare me deklaratën e saj të vitit 2008, apo në deklaratën e pronave në vitin 2017, me anë të së cilës të konfirmonte transfertën e të ardhurave. Akti i dhuratës përcaktonte datën 22 gusht 2013 si datën e dhuratës, gjë e cila binte në kundërshtim me deklaratat e bëra në vitin 2008 dhe 2017, ku deklarohesh se kërkuesja dhe bashkëshorti i saj kishin përfituar nga të ardhurat në vitin 2008. Pas shqyrtimit të një deklarate nga noteri në mars 2018, KPK-ja me të drejtë kishte hedhur poshtë argumentin sipas së cilit pretendohesh se noteri kishte bërë një gabim kur kishte redaktuar/ndryshuar dokumentin në vitin 2013. Noteri e pranoi gabimin; ai e bëri këtë gjë pesë vjet më vonë (pas dhuratës) dhe e bëri këtë në mungesë të personit që kishte dhuruar shumën dhe në shkelje të legjislacionit të zbatueshëm që lejonte redaktimin/ndryshimin teksa dokumenti ligjor po hartohesh për t'u nënshkruar nga pala/palët. KPK-ja ishte justifikuar për përfundimin se kërkuesja kishte bërë deklaratë të rreme për burimin e të ardhurave përftuar nga shitja e trojeve nga vjehrra e saj, në përpykjet për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të përdorur për të blerë apartamentin.

Në lidhje me të ardhurat nga shitja e një trualli tjetër me sipërfaqe 2,040 m<sup>2</sup> në vitin 2010 si burim i të ardhurave për apartamentin, në deklaratën e saj të vitit 2010, kërkuesja kishte deklaruar atë shitje bërë nga vjehrra e saj. Megjithatë, në deklaratën e vitit 2008, pjesa e mbetur e truallit nën pronësinë e saj ishte 1,500 m<sup>2</sup>. Kërkuesja nuk kishte paraqitur dokumente me deklaratën e saj të pasurisë të vitit 2017 me anë të së cilës të konfirmonte transfertën nga vjehrra e saj për të apo bashkëshortin e saj. Vjehrra e saj nuk ishte e listuar në certifikatat familjare si pjesë e familjes së kërkueses. Edhe nëse pranohet se ajo kishte jetuar me ta gjatë asaj periudhe, ajo kishte qenë e lirë të paraqiste të ardhurat. Mbetej detyrë e kërkueses që të provonte në mënyrë bindëse, në mbështetje të nenit D § 3 të Aneksit të Kushtetutës, se ajo kishte përfituar nga ato para (shih paragrafin 27 më poshtë).

Në lidhje me kursimet familjare, nga deklaratimet vjetore rezultonte se ato janë përdorur për të paguar apartamentin si më poshtë: 10,000 euro në vitin 2009, 20,000 euro në vitin 2010, dhe 10,000 euro në vitin 2011, me një total prej 5,530,900.

Kërkuesja nuk kishte deklaruar kursime për periudhën nga viti 2003 deri në vitin 2006. Ajo kishte deklaruar 6,365,920 euro nga kursimet familjare më periudhën nga viti 2007 deri në vitin 2011: 300,000 lekë në vitin 2007, 1,700,000 lekë në vitin 2008; 1,300,000 lekë në vitin 2009; 1,677,620 lekë (1,400,000 lekë dhe 2,000 euro) në vitin 2010; dhe 1,388,300 lekë (1,250,000 lekë dhe 1,000 euro) në vitin 2011. Megjithatë, mbështetur në të ardhurat e deklaruara prej saj në deklaratat vjetore për periudhën 2007-11, duke hequr shpenzimet për jetesën sipas të dhënave zyrtare të publikuara nga Instituti i Statistikave në Shqipëri për atë periudhë, kursimet reale për secilin vit do të duhej të ishin si më poshtë: 149,568 lekë në vitin 2007; 2,068,880 lekë në vitin 2008; 132,182 lekë në vitin 2009; minus 650,918 lekë në vitin 2010; dhe minus 83,141 lekë në vitin 2011. Duke krahasuar kursimet e llogaritura si më sipër me ato të deklaruara nga kërkuesja në deklaratimet vjetore, diferencat e pajustificuara ishin si më poshtë: teksa për vitin 2008 ajo kishte deklaruar më pak sesa ajo mund të kursente në shumën prej 368,380 lekësh, për vitin 2007 dhe 2009-11 ajo kishte deklaruar më shumë sesa mund të kursente në shumën e si më poshtë: 150,432 lekë në vitin 2007; 1,167,818 lekë në vitin 2009; 2,328,538 lekë në vitin 2010; dhe 1,471,441 lekë në vitin 2011. Në këtë mënyrë, shumën në total prej 4,749,349 lekësh nuk mund të justifikohesh ligjërisht si kursime. Thënë ndryshe, ajo mund të justifikonte vetëm diferencën si shumë e arsyeshme kursimesh.

b) Për sa ka të bëjë me automjetin Toyota, KPA-ja la në fuqi gjetjet e KPK-së në lidhje me çmimin e blerjes. Gjithashtu, sipas të dhënave nga Drejtoria për Parandalimin e Pastrimit të Parave, 12,000 euro ishin deklaruar se vinin nga kursimet familjare dhe kursimet nga puna të A.M. Nga të dhënat zyrtare rezultonte se A.M. nuk kishte pasur burime të mjaftueshme nga të ardhurat e fituara nga puna, për t'i dhënë hua familjes së kërkueses 12,000 euro. Provat e dorëzuara në vitin 2018 për të justifikuar se A.M. i kishte marrë paratë nga kushëriri i tij në Greqi binin në kundërshtim me të dhënat e mëparshme. Gjithashtu, nuk dukej bindës as fakti se A.M. kishte marrë një hua prej 50,000 eurosh në vitin 2016 që do të shlyhej në vitin 2017, dhe në të njëjtën kohë i kishte dhënë hua një pjesë të asaj shume bashkëshortit të kërkueses për t'u shlyer në vitin 2018. Përsëri, kërkuesja nuk kishte paraqitur ndonjë provë se në fakt ajo kishte marrë 12,000 euro.

Sipas kontratës për shitjen e makinës së vjetër në muajin shtator 2016, çmimi i blerjes prej 4,000 eurosh ishte paguar në një datë të pacaktuar. Nuk ekzistonin prova të përshtatshme për shlyerjen reale të asaj shume, veçanërisht përpara blerjes së automjetit Toyota. Një deklaratë e noterizuar e hartuar në muajin mars 2018 përcaktonte se ajo shumë ishte shlyer në vitin 2016 dhe se më pas, palët kishin formalizuar transaksionin e tyre me anë të kontratës. Në këtë mënyrë, nuk kishte prova se kërkuesja kishte 4,000 euro nga shitja e makinës së vjetër dhe më pas, e kishte përdorur këtë shumë për të blerë makinën Toyota. Ajo kishte bërë një deklaratë të rreme dhe nuk kishte provuar ligjshmërinë e asaj shume.

c) Në deklaratën e saj të *vetting*-ut, kërkuesja nuk kishte deklaruar shitjen e një tjetër makine në vitin 2008, duke fshehur në këtë mënyrë të ardhurat prej 200,000 lekësh. Në deklaratën vjetore për vitin 2007, ajo kishte deklaruar se ajo i kishte dhënë hua 300,000 lekë kumatit të saj, pa ndonjë dokumentacion për ta provuar këtë gjë. Në deklaratat e saj të mëpasshme ose në deklaratën e *vetting*-ut, ajo nuk kishte përmendur kthimin e asaj shume, për të cilën, sidoqoftë, ajo nuk kishte kapacitetin e mjaftueshëm financiar për të dhënë hua. Në këtë mënyrë, ajo kishte bërë një deklaratë të rreme.

22. Në përgjigje të ankesës së kërkueses në lidhje me konstatimin e KPK-së se pasuria e saj i tejkalonte më shumë sesa dyfish të ardhurat e ligjshme, dhe pas vlerësimit të të gjitha fakteve përkatëse dhe të gjitha provave, në lidhje me të dhe pronat e bashkëshortit të saj nga viti 2003 deri në vitin 2016, trupi gjykues i KPA-së arriti në përfundimin se kërkuesja nuk kishte provuar ligjshmërinë për sa më poshtë:

a) apartamenti në Tiranë – 4,749,349 lekë, pasi kjo shumë ishte më shumë sesa kërkuesja mund të kishte kursyer në mënyrë të arsyeshme gjatë periudhës 2007-11, duke pasur parasysh të ardhurat e saj të ligjshme.

b) apartamenti në Lezhë – 3,418,000 lekë (25,000 euro), sepse kërkuesja nuk kishte pasur kurrë një dokument që të konfirmonte pronësinë e saj ndaj apartamentit të shembur; njësia e shërbimeve – 6,000,000 lekë për të njëjtën arsye;

c) automjeti Toyota – 16,000 euro (2,184,160 lekë) sepse A.M. nuk kishte pasur kapacitetin financiar për të dhënë hua 12,000 euro dhe kërkuesja nuk kishte asnjë provë dokumentare për të provuar birimin e 4,000 eurove të përdorura për blerjen e asaj makine.

Trupi gjykues i KPA-së arriti në përfundimin se në total pasuria familjare e kërkueses ishte 24,637,339 lekë, ndërsa pasuria e saj e përfutur ligjërisht ishte 8,772,156 lekë, që është 2.8 herë më pak. Duke iu referuar nenit D §§ 3 dhe 4 të aneksit të Kushtetutës (shih paragrafët 27 dhe 35 më poshtë), trupi gjykues i KPA-së la në fuqi masën disiplinore dhënë me anë të vendimit të KPK-së më 20 prill 2018.

### III. INFORMACIONE TË TJERA

23. Pasi qeveria ishte njoftuar për kërkesën, në vitin 2020, kërkuesja informoi Gjykatën se në vitin 2018 ajo kishte aplikuar pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë (Shoqata e Avokatëve) për t'u "regjistruar" si avokate. Sipas Qeverisë, ajo thjesht depozitoi një kërkesë për informacion për legjislacionin përkatës. Me anë të shkresës së datës 9 nëntor 2018, kryetari i Dhomës u përgjigj si më poshtë:

“Lënda: një përgjigje

Në përgjigje të kërkesës suaj depozituar pranë nesh nëpërmjet shkresës suaj për informacion në lidhje me ushtrimin e profesionit të avokatit dhe së drejtës për t’iu nënshtruar provimit [përkatës], ju bëjmë me dijeni si më poshtë.

- Sipas ligjit nr. 55/2018..., ushtrimi i profesionit të avokatit është një e drejtë e çdo shtetasi shqiptar apo të huaj, i cili përmbush kriteret e parashikuara në nenet 13 dhe 14 të ligjit. Pjesa më e rëndësishme e shprehur në ato dispozita për rregullimin e së drejtës për të ushtruar profesionin e avokatit është marrja e titullit të “avokatit”, që, sipas nenit 13 ... duhet të merret duke kaluar me sukses provimin kualifikues.

- Duke qenë se ju nuk keni kaluar me sukses procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, mbështetur në seksionin 13(2)(e) ..., juve ju është mohuar me ligj e drejta për të aplikuar për titullin e “avokatit” – dhe, rrjedhimisht, e drejta për të ushtruar profesionin e avokatit – derisa të shuhet masa disiplinore sipas legjislacionit të posaçëm.”.

KUADRI DHE PRAKTIKA LIGJORE PËRKATËSE

I. LEGJISLACIONI DHE PRAKTIKA SHQIPTARE

**A. Ligji për Deklarimin e Pasurive (ligji nr. 9094 i datës 10 prill 2003), i ndryshuar**



24. Sipas nenit 4 të Ligjit për Deklarimin e Pasurive, zyrtarëve publikë iu kërkohet të paraqesin deklaratimet vjetore pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (“ILDKPKI”) për interesat privatë, burimet e përdorura për krijimin e tyre, si edhe për detyrimet financiare, në lidhje me, *inter alia*, pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale ndaj tyre; pasurive të luajtshme, që mund të regjistrohen në regjistrat publikë; artikujt me vlerë të veçantë mbi 300,000 lekë; detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë; të ardhurat personale për atë vit nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo aktivitet që sjell të ardhura personale; interesat privatë që lidhen me, përmbajnë, mbështeten në ose vijnë nga marrëdhëniet familjare ose të bashkëjetesës; çdo shpenzim i deklarueshëm, me vlerë më të madhe sesa 300,000 lekë, i bërë gjatë vitit të deklaratës.

25. Sipas nenit 38 të ligjit, deklarimi i rremë i pasurive përbën vepër penale sipas legjislacionit penal të zbatueshëm (neni 257/a i Kodit Penal).

### **B. Procesi i *vetting*-ut**

26. Për një përmbledhje të legjislacionit vendës të zbatueshëm dhe referencave të tjera shih *Xhoxhaj kundër Shqipërisë* (nr. 15227/19, §§ 93-209, 9 Shkurt 2021). Dispozitat që kanë veçanërisht lidhje me procesin e *vetting*-ut në çështjen konkrete janë si më poshtë.

#### *1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*

27. Neni D i Aneksit të Kushtetutës parashikon si më poshtë:

#### Neni D – Vlerësimi i pasurive

“1. Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaratimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

2. Subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave kontrollon deklaratën e pasurisë dhe i dorëzon Komisionit një raport për ligjshmërinë e pasurive, për saktësinë dhe plotësinë e deklaratimit, sipas ligjit.

3. Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj.

4. Nëse subjekti i rivlerësimit ka një pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ai prezumohet fajtor për shkeljen disiplinore, përveçse kur ai paraqet prova që vërtetojnë të kundërtën.

5. Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon deklaratën e pasurisë në kohë sipas ligjit, ai shkarkohet nga detyra. Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë, në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.”

#### *2. Ligji për Rivlerësimin (ligji nr. 84/2016 për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve)*

28. Neni 4(1) parashikon se rivlerësimi kryhet mbështetur në tri kritere: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale. Neni 4(a) parashikon se KPK-ja dhe KPA-ja janë institucionet që vendosin për rivlerësimin përfundimtar të personave të kontrolluar, dhe se vendimi bëhet mbështetur në një ose më shumë kritere, në vlerësimin e përgjithshëm të të tria kritereve, ose në një vlerësim tërësor të procedurave. Sipas nenit 4(5), si KPK-ja edhe KPA-ja ushtrojnë funksionet e tyre si organe të pavarura, mbështetur në parimet e barazisë përpara ligjit, kushtetueshmërisë, ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe parimeve të tjera që garantojnë të drejtën për

një gjykim të drejtë të personit të rivlerësuar/vetuar. Sipas nenit 4(6), organet e *vetting*-ut mund të zbatojnë procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, ose në Ligjin për Gjykatat Administrative (ligji nr. 49/2012; shih për shembull paragrafin 45 më poshtë), kur këto procedura nuk referohen në Kushtetutë ose në Ligjin për Rivlerësimin.

29. Neni 30 parashikon se objektivi i vlerësimit të pasurive është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, ligjshmëria e burimit të përdorur për përfitim ose krijimin e tyre, përmbushja e detyrimeve financiare, duke përfshirë interesat privatë të personit të rivlerësuar dhe të personave të lidhur me të. Sipas nenit 31(1), personi i rivlerësuar duhet të dorëzojë një deklaratë për pasuritë pranë ILDKPKI-së.

30. Neni 32 parashikon si më poshtë:

“1. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

2. Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor.

...

4. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

5. Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit.”

31. Neni 33 parashikon se ILDKPKI-ja është institucioni përgjegjës për verifikimin e deklaratës së pasurive. Sipas nenit 33(5), ILDKPKI-ja, pas përfundimit të vlerësimit, përgatit një raport të arsyetuar dhe të detajuar ku përcakton, nëse: i. deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, i mbështetur me burime financiare të ligjshme, dhe nëse ka ndonjë konflikt interesi; ii. ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; iii. janë fshehur pasuri; iv. personi i rivlerësuar ka bërë deklaratë të rremë; v. personi i rivlerësuar është përfshirë në konflikt interesi.

32. Sipas nenit 45, KPK-ja, KPA-ja dhe vëzhguesit ndërkombëtarë (të emëruar nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit) hetojnë dhe shqyrtojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurat e rivlerësimit. Ata mund të kërkojnë informacione nga çdo autoritet publik. Ata administrojnë dokumente që provojnë ekzistencën e veprimeve, fakteve ose ndonjë situatë tjetër të nevojshme për realizimin e hetimit administrativ.

33. Sipas nenit 49(1), organet e rivlerësimit marrin dokumente ligjore, mbledhin deklaratat nga personi i rivlerësuar, dëshmitarët, ekspertët dhe nga publiku, dhe marrin dokumente të tjera me shkrim për të përcaktuar faktet dhe rrethanat për secilën çështje. Sipas nenit 49(6)(a), organet e rivlerësimit mund të mos pranojnë marrjen e provave të reja, nëse për shembull, marrja e atyre provave është e panevojshme. Sipas nenit 49(9), organet e *vetting*-ut japin arsye për kundërshtimin e kërkesës për marrjen e provave të reja. Sipas nenit 51, nëse personi i rivlerësuar nuk paraqet prova, ose provat e ofruara nuk janë të plota, organet e rivlerësimit mund të vendosin mbështetur në provat që tashmë janë vënë në dispozicionin e tyre.

34. Neni 52 parashikon se organet e *vetting*-ut duhet të udhëhiqen nga parimet e objektivitetit dhe të proporcionalitetit. Nëse ata arrijnë në përfundimin se provat e mbledhura gjatë hetimit

administrativ në përputhje me nenin 45 kanë nivelin e pranueshmërisë, personi i rivlerësuar ka barrën e provës për të paraqitur prova ose të japë shpjegime të tjera për të kundërtën.

35. Sipas nenit 61, shkarkimi nga detyra mund të urdhërohet në këto raste:

“1. Kur rezulton se ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të.

2. Kur rezulton me probleme serioze gjatë kontrollit të figurës, sepse ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar që bën të pamundur vazhdimin e detyrës.

3. Kur rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të këtij ligji.

4. Kur rezulton si i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale.

5. Në rast se nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2, të këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.”

### **C. Statusi i prokurorëve në Shqipëri**

#### *1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*

36. Neni 148 i Kushtetutës (ndryshuar me ligjin nr. 76 të datës 22 korrik 2016) parashikon si më poshtë:

“1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj.

2. Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit.

3. Prokuroria është organizuar dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor...”

#### *2. Ligji për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (ligji nr. 96/2016 për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve)*

37. Neni 2 parashikon statusin e “magjistratëve”, i cili shtrihet për prokurorët dhe gjyqtarët, me përjashtim të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

38. Neni 3 (“Vlerat themelore”) parashikon si më poshtë:

“1. Magjistrati ushtron funksionet e tij, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin.

2. Magjistrati ushtron funksionet në mënyrë të pavarur, duke vlerësuar faktet dhe interpretuar ligjin, sipas bindjes së tij të brendshme, i lirë nga çdo ndikim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë nga çdo palë dhe për çdo arsye.

3. Magjistrati nuk duhet të krijojë kontakte të papërshtatshme dhe nuk duhet të ndikohet nga pushteti ekzekutiv ose nga pushteti legjislativ. Magjistrati duhet të marrë çdo masë për të qenë dhe të duket se është jashtë çdo ndikimi prej tyre. Magjistrati njofton menjëherë Këshillin dhe kryetarin, në rast se evidenton ndërhyrje ose ushtrim të ndikimit të papërshtatshëm ndaj tij.

4. Magjistrati ushtron funksionet gjyqësore në mënyrë të paanshme, pa ndikim dhe pa paragjykime.

5. Sjellja e magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij garanton ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, profesioni ligjor dhe palëve në proces. Magjistrati ushtron funksionet me drejtësi, në mënyrë korrekte, në kohë të arsyeshme, të ndërgjegjshme, të kujdesshme, të zellshme dhe sistematike, me objektivitet, vetëpërmbytje dhe maturi.”

#### *3. Ligji për Prokurorinë*

##### **a) Ligji nr. 8737 i datës 12 shkurt 2001 (i ndryshuar në vitin 2003 dhe 2008)**

39. Sipas nenit 17 të ish-Ligjit për Prokurorinë (zëvendësuar nga ligji nr. 97/2016, i datës 6 tetor 2016), për t’u emëruar si prokuror, një person duhej, *inter alia*, të kishte arsimin e lartë, të kishte përfunduar kursin përkatës të Shkollës së Magjistraturës dhe të kishte moral të lartë dhe cilësi profesionale.

40. Shkeljet disiplinore përfshinin, *inter alia*, veprimet që diskreditonin rëndë funksionin e prokurorit, ose që, sipas ligjit, nuk pajtoheshin me të (neni 32). Shkelje të tilla dënoheshin me vërejtje, vërejtje me paralajmërim për pushim nga detyra, ulje në detyrë ose shkarkim nga detyra (neni 33).

41. Gjykata Kushtetuese parashikonte se veprimet e rënda që diskreditonin funksionin zyrtar përfshinin sjelljen e papërshtatshme dhe të padenjë si gjatë kryerjes së detyrave zyrtare ashtu edhe jashtë atyre detyrave (vendimi nr. 75/2002).

**b) Ligji nr. 97/2016 i datës 6 tetor 2016**

42. Neni 6 (“Pavarësia e Prokurorëve”) parashikon si më poshtë:

“1. Në ushtrimin e funksioneve të tyre, prokurorët kryejnë veprime, parashitjnë kërkesa dhe marrin vendime në mënyrë të pavarur, bazuar në parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë.

2. Prokurorët u nënshtrohen udhëzimeve të përgjithshme me shkrim të prokurorit më të lartë, sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Ligji garanton pavarësinë dhe autonominë e nevojshme për marrjen e vendimeve gjatë ushtrimit nga prokurorët të funksionit të tyre kushtetues e ligjor, pavarësisht ndikimit të paligjshëm të brendshëm apo të jashtëm nga çdo autoritet publik a privat.”

43. Sipas nenit 95, në rastin kur provohet një shkelje disiplinore, organi kompetent vendos një masë disiplinore në përputhje me parashikimet e Ligjit për Nëpunësin Civil (ligji nr. 152/2013 për nëpunësin civil). Masat disiplinore përfshijnë vërejtje, mbajtje deri në një të tretën nga paga e plotë deri në gjashtë muaj, pezullim nga e drejta për t’u rritur në detyrë dhe shkarkim nga shërbimi civil (neni 58 i ligjit për Nëpunësin Civil).

*4. Kodi i Etikës për Prokurorët*

44. Kodi u miratua më 19 qershor 2014 me anë të urdhrit nr. 141 të Prokurorit të Përgjithshëm. Ai përmban kërkesat mbështetur në standarde të larta për sjelljen profesionale të prokurorëve brenda dhe jashtë aktiviteteve të tyre profesionale (*inter alia*, seksioni 8 i Kodit). Veprimet që diskreditojnë figurën e prokurorit sipas parashikimit të Nenit 149 të Kushtetutës dhe nenit 32 të ish-Ligjit për Prokurorinë (shih paragrafët 40–41 më sipër), përbëjnë shkelje të këtyre kërkesave dhe mund të çojnë në procedura disiplinore (neni 17 i Kodit).

**D. Legjislacioni dhe dokumente të tjera përkatëse**

*1. Ligji për Gjykatat Administrative (ligji nr. 49/2012 për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative)*

45. Neni 47 parashikon se një ankues mund të mos paraqesë fakte të reja apo të kërkojë prova të reja për apelimin, në rast se ai ose ajo nuk mund ta demonstrojë këtë gjë, pasi jo për fajin e tij apo të saj, nuk u bë e mundur që të paraqiteshin faktet e reja apo të kërkoreshin prova të reja gjatë shqyrtimit të çështjes në shkallë të parë sipas afateve të parashikuara në ligj.

*2. Ligji për Avokatët (ligji nr. 55/2018, për profesionin e avokatit)*

46. Sipas nenit 5, një personi i cili nuk ka marrë titullin e avokatit, sipas parashikimeve të ligjit, nuk i lejohet që të veprojë si përfaqësues i palëve ose të hartojë dokumente me shkrim për palët në proceset gjyqësore ku palët mund të përfaqësohen nga një avokat sipas legjislacionit në fuqi, apo të jetë përfaqësues i palës kur nuk është pjesë e njërës prej kategorive të subjekteve që mund të përfaqësojnë palët në mbështetje të legjislacionit procedural në fuqi.

47. Sipas nenit 7, teksa ushtron profesionin, një avokat nuk mund të ushtrojë njëkohësisht detyrat e gjyqtarit, prokurorit, noterit, përmbaruesit, si edhe as ndonjë funksion apo detyrë tjetër në organet publike, përveç mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë brenda ose jashtë vendit. Avokatët e punësuar nga subjekte private mund të ushtrojnë profesionin e avokatit vetëm mbështetur në një marrëveshje me shkrim të nënshkruar për këtë qëllim midis avokatit dhe punëdhënësit privat për të

siguruar mbarëvajtjen e detyrave të avokatit sipas ligjit. Një kopje e marrëveshjes me shkrim e nënshkruar në përputhje me nenin 7(2) duhet të depozitohet pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

48. Sipas nenit 13(1), e drejta për të ushtruar profesionin fillon në momentin e marrjes së titullit të “avokatit”. Sipas nenit 13(a)(e), e drejta për të marrë titullin “avokat” është e hapur për qytetarët shqiptarë të cilët nuk janë shkarkuar nga detyra ose nga një funksion publik, për një shkelje të integritetit etik, me anë të një vendimi të formës së prerë nga autoriteti kompetent, me përjashtim të çështjeve kur masa disiplinore është shuar sipas legjislacionit të zbatueshëm.

49. Neni 51 parashikon se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë është gjykata kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative krijuar nga vendimet e Komisionit Disiplinor parashikuar nga Ligji për Avokatët.

### *3. Statuti i Dhomës së Avokatëve Shqipëri*

50. Neni 49 i Statutit të Dhomës Kombëtare të Avokatëve të vitit 2019 parashikon afatin referuar në nenin 13(2)(e) të Ligjit për Avokatët për përfundimin e masës disiplinore ndaj personave të cilët aplikojnë për marrjen e titullit të avokatit. Për gjyqtarët dhe prokurorët, të cilët me anë të një vendimi të formës së prerë, nuk kalojnë procesin e *vetting*-ut, për shkak të vlerësimit të pasurive dhe kontrollit të figurës, afati për shuarjen e masës disiplinore është pesë vjet. Nëse shkarkimi nga detyra bëhet për shkak të vlerësimit të kompetencës profesionale, afati nuk është i zbatueshëm.

## II. MATERIALE TË TJERA TË LIDHURA ME ÇËSHTJEN

### **A. Komisioni i Venecias**

51. Raporti për standardet evropiane në lidhje me pavarësinë në sistemin gjyqësor: Pjesa II: Prokuroria (miratuar në vitin 2010) parashikon se prokurori – duke qenë se ai ose ajo vepron në emër të shoqërisë në tërësi dhe për shkak të pasojave të rënda të dënimit penal – duhet të veprojë me një standard më të lartë sesa pala ndërgjyqëse në çështjen civile. Edhe në sistemet të cilët nuk e konsiderojnë prokurorin si pjesë të gjyqësorit, prokurori pritet që të veprojë në mënyrë të ligjshme. Një prokuror, ashtu si edhe një gjyqtar, nuk mund të trajtojë një çështje ku ai ose ajo ka interes personal, dhe mund t’u nënshtrohet kufizimeve të caktuara, me qëllim ruajtjen e paanshmërisë dhe integritetit të tij. Të gjitha këto detyra theksojnë nevojën për të punësuar si prokurorë personat e duhur me një reputacion të lartë dhe karakter të mirë. Cilësitë e kërkuara nga një prokuror janë të ngjashme me ato të një gjyqtari dhe kërkojnë që të zbatohen procedurat e duhura për emërimin dhe promovimin. Është e nevojshme që një prokuror, ashtu edhe si një gjyqtar, mund të ketë raste të marrë vendime që nuk mirëpritin nga publiku, dhe që mund të bëhen subjekt i kritikave në medie dhe mund të bëhen subjekt edhe i polemikave politike. Për këto arsye, është e nevojshme që të sigurohet afati i duhur në detyrë dhe organizimet e duhura për promovimin, disiplinën dhe shkarkimin, të cilat do të garantojnë se një prokuror nuk mund të viktimizohet për marrjen e një vendimi që nuk mirëpritet. Në rastin kur një gjyqtar nuk plotëson standardin e kërkuar, gjyqtari i paanshëm mund të korrigjojë gabimin që është bërë. Megjithatë, nuk ka garanci për një korrigjim të tillë dhe, në çdo rast, mund të shkaktohet një dëm i madh. Një sistem ku si prokurori edhe gjyqtari veprojnë sipas standardeve më të larta të integritetit dhe paanshmërisë ofron një mbrojtje më të madhe të të drejtave të njeriut sesa një sistem i cili mbështetet vetëm te gjyqtari.

52. Opinioni CDL-AD(2021)028 për përgjegjësinë e zyrtarëve publikë për deklarimin e pasaktë të pasurisë në Ukrainë përcakton se detyra e zyrtarëve publikë për të dorëzuar deklarata të sakta për pasuritë ekziston në forma të ndryshme, në shumë sisteme juridike demokratike. Për të qenë efikas, ky mekanizëm ligjor duhet të shoqërohet me sanksionet e duhura, në varësi të një sërë faktorëve të tillë si kategoria e zyrtarëve publikë të përfshirë, shumata e pasurive të padeklaruar, të ardhurat mesatare në një shtet të caktuar si edhe niveli i problemit të korrupsionit në këtë shtet.

### **B. Këshilli Konsultativ i Prokurorëve Evropianë (KKPE)**

53. Opinioni nr. 13 (2018) për pavarësinë, llogaridhënien dhe etikën e prokurorëve, nga KKPE-ja që vepron sipas mandatit të dhënë nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës parashikon si më poshtë:

“21. Respektimi i rregullave etikë është një detyrë themelore që duhet të udhëheqë aktivitetet e prokurorëve. Është e rëndësishme të jetë e mundur referimi te përpilimet që përmbajnë parime etike të prokurorëve të cilat duhet të udhëheqin sjelljen e tyre.

22. Sjellja e prokurorëve, ashtu edhe si gjyqtarët, nuk mund të lihet vetëm në diskrecionin e tyre, si gjatë detyrës edhe jashtë saj. Një gjë e tillë është veçanërisht e rëndësishme kur vlerësohen aktivitete të prokurorëve dhe në procedurat disiplinore ndaj tyre.

...

51. Respektimi i shtetit të së drejtës kërkon standardet më të larta etike dhe profesionale në sjelljen e prokurorëve, ashtu si edhe të gjyqtarëve, si gjatë detyrës edhe jashtë saj, gjë e cila bën të mundur fitimin e besimit të shoqërisë të drejtësisia. Prokurorët veprojnë në emër të njerëzve dhe në interesin publik. Për këtë arsye, ata duhet të kujdesen gjithmonë për integritetin personal dhe të veprojnë në përputhje me ligjin, në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe objektive, duke respektuar dhe ruajtur të drejtat dhe liritë themelore, duke përfshirë prezumimin e pafajësisë, të drejtën për një gjykim të drejtë, dhe parimet e barazisë së armëve, ndarjeve të pushteteve, dhe forcën detyruese të vendimeve gjyqësore. Ata kanë për detyrë të jenë të lirë nga ndikimi politik dhe ndikime të tjera.

...

55. Ata duhet të demonstrojnë integritet të plotë në sjelljen e tyre dhe të mos pranojnë asnjë lloj përfitimi apo pagese që kanë lidhje me përmbajtjen e zgjedhjeve të tyre, dhe as të zhvillojnë ambicie profesionale që mund të udhëheqin vendimet e tyre në mënyrë të gabuar (për shembull për të kënaqur një autoritet të caktuar politik ose administrativ).”.

#### **C. Konferenca e Prokurorëve të Përgjithshëm të Evropës (KPPE)**

54. Udhëzimet Evropiane për etikën dhe sjelljen e prokurorëve publikë (“Udhëzimet e Budapestit”), KPPE (2005) 05, rekomandojnë se prokurorët publikë gjatë gjithë kohës duhet të ushtrojnë standardet më të larta të integritetit dhe të kujdesit, dhe – ashtu si edhe me sjelljen në jetën private – nuk duhet të komprometojnë integritetin real ose të perceptuar në mënyrë të arsyeshme, drejtësinë dhe paanshmërinë e prokurorisë publike me anë të veprimtarive në jetën e tyre private. Ata duhet të respektojnë dhe t’i binden ligjit gjatë gjithë kohës, dhe duhet të sillen në mënyrë të tillë që të përforcojnë dhe ruajnë besimin e publikut në profesionin e tyre.

#### **D. Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO)**

55. GRECO monitoron respektimin nga ana e shteteve të standardeve kundër korrupsionit të Këshillit të Evropës. Ai punon në cikle, të njohura si raundet e vlerësimit, ku secili cikël trajton tema specifike. Ekipi i vlerësimit të GRECO (GET) përgatit një raport vlerësimi, i cili mund të përmbajë rekomandime që kërkojnë marrjen e masave nga shteti për të garantuar pajtueshmërinë me të (shih edhe *Xboxhaj kundër Shqipërisë*, nr. 15227/19, §§ 217-20, 9 shkurt 2021).

56. Në lidhje me prokurorët në Shqipëri, Raporti i Vlerësimit të GRECO-s, i publikuar në vitin 2014 brenda raundit të katërt të vlerësimit, përcakton si më poshtë:

“106. Prokuroria ... nuk është as pjesë e ekzekutivit dhe as e degëve të pushtetit gjyqësor, për shkak të natyrës së funksioneve të saj; ajo është një organ *sui generis*, i vetmi në llojin e tij, garancitë e autonomisë së saj përforcohen me anë të ndalimit të anëtarësimit në një parti politike dhe administrimit të buxhetit të saj...

115. “Cilësitë e moralit të lartë” janë vendosur si një kërkesë e përgjithshme për emërimin dhe rritjen në detyrë të prokurorëve. Megjithatë, GET u bë me dije se teksta shqyrton të dhënat për kandidatët për prokurorë, Këshilli i Prokurorëve mbështetet në opinionin paraprak të departamenteve të burimeve njerëzore të Shkollës së Magjistraturës dhe të policisë gjyqësore, dhe

nuk kryen kontrole të veçanta për integritetin. GET thekson se rregullat e detajuara për paraqitjen, përzgjedhjen, verifikimin dhe testimin e kandidatëve për prokurorë përcaktohen nga Prokurori i Përgjithshëm. Ky i fundit përcakton edhe kriteret për vlerësimin e brendshëm dhe lëshon rregulla për sistemin e pikëve për rritjen në detyrë. Shqyrtimi i një formulari tip për vlerësimin megjithatë tregon se kriteret për vlerësimin e moralit të prokurorëve dhe cilësitë etike nuk janë përcaktuar. Në këtë mënyrë, me qëllim përforcimin e uniformitetit, parashikueshmërisë dhe transparencës për emërimin dhe rritjen në detyrë të prokurorëve, GRECO rekomandon përmirësimin e mëtejshëm të kriterëve për vlerësimin e cilësive etike të prokurorëve, veçanërisht duke garantuar se kriteret janë objektive dhe transparente...

Parimet etike dhe rregullat për sjelljen

....

127. Për Prokurorinë në tërësi nuk zbatohet asnjë kod sjelljeje apo etike. Duke qenë se anëtarësimi në Shoqatën e Prokurorëve është vullnetar dhe nuk mbulon të gjithë prokurorët shqiptarë, jo të gjithë janë të lidhur me Kodin e përgatitur nga Shoqata, dhe nuk janë nën juridiksionin e Komisionit të saj të Etikës. Gjithashtu, GET u vu në dijeni se vet Komisioni nuk është operacional dhe, që prej krijimit të tij, ai nuk ka shqyrtuar ndonjë shkelje të rregullave të etikës... GRECO rekomandon, se: i. duhet të përgatitet dhe të zbatohet rregullisht një grup standardesh/kod i qartë etik për sjelljen profesionale që duhet të jetë i zbatueshëm për të gjithë prokurorët; dhe ii. prokurorëve iu duhet ofruar udhëzime, këshillim dhe trajnim i detyruar në vendin e punës mbi etikën, konfliktet e interesit dhe parandalimin e korrupsionit brenda niveleve të tyre.

...

Deklarimi i pasurisë, të ardhurave, detyrimeve dhe interesave

135. Të gjithë prokurorët duhet të deklarojnë pronat, të ardhurat, detyrimet dhe interesat e tyre, brenda së njëjtës fushë veprimi dhe me të njëjtat kushte si deputetët dhe gjyqtarët pranë Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurisë (ILDKP). Shkeljet sanksionohen me anë të gjobave administrative, me përjashtim të refuzimit për të deklaruar apo mosdeklarimit, fshehjes ose deklarimit të rremë të pasurisë, të cilat janë vepra penale dhe shkelje shumë të rënda disiplinore që çojnë në shkarkimin nga detyra. Ashtu si edhe me gjyqtarët, mungesa e deklarimit në kohë, *online*, të elementeve përbërëse në deklaratimet e prokurorëve për pasurinë shkatërron transparencën dhe dëmton interesin legjitim të publikut në marrjen e informacioneve për personat që ushtrojnë një funksion zyrtar. Edhe pse GRECO tërhiqet nga adresimi i kësaj çështjeje me anë të një rekomandimi të veçantë, ai i fton autoritetet të publikojnë të dhëna në faqen zyrtare të Prokurorisë ose të ILDKP-së, duke u kushtuar vëmendje privatësisë dhe sigurisë së prokurorëve dhe personave të lidhur me ta, të cilët kanë detyrimin për të raportuar.

....

137. Deklarimet e prokurorëve për pasurinë monitorohen nga ILDKP-ja në të njëjtën mënyrë dhe qëllim edhe për gjyqtarët dhe deputetët, me disa përjashtime: deklarimet e Prokurorit të Përgjithshëm duhet të kontrollohen çdo dy vjet, deklarimet e prokurorëve të apelit dhe të atyre të caktuar në Prokurorinë e Përgjithshme çdo tre vjet, dhe deklarimet e bëra nga kategoritë e tjera të prokurorëve i nënshtrohen kontrollit rastësor të përvitshëm. Drejtoria e Inspektimeve dhe e Burimeve Njerëzore nën Prokurorinë e Përgjithshme parashikon udhëzimet për mënyrën e plotësimit të deklaratave për të gjithë prokurorët dhe paraqet formularët e plotësuar rregullisht pranë ILDKP-së, brenda afateve të caktuara nga ligji... Ashtu si me gjyqtarët, zbatohet një qasje me nivele, sipas së cilës, në varësi të vjetërsisë në pozicion, disa kategori prokurorësh u nënshtrohen kontroleve më të shpeshta dhe të detajuara. Sipas kontekstit të Prokurorisë, një qasje e tillë e rregullt rezulton të jetë e justifikuar, por mangësitë në funksionimin e ILDKP-së, tashmë të diskutuara në këtë raport, nuk duhet të anashkalohen.”

## **E. Konventat e Këshillit të Evropës**

57. Sipas Konventës së Ligjit Penal për Korrupsionin (ETS nr. 173), një “zyrtar publik” kuptohet duke iu referuar përkufizimit të fjalës “zyrtar”, “zyrtar publik”, “kryebashkiak”, “ministër” ose “gjyqtar” në ligjin vendës të shtetit në të cilin personi konkret kryen atë funksion dhe sipas legjislacionit penal; termi “gjyqtar” përfshin prokurorët dhe mbajtësit e funksioneve gjyqësore (neni 1, shih edhe nenet 26 § 3 dhe 30 § 2). Një qëndrim i ngjashëm rezulton të miratohet në Konventën e Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e të Ardhurave nga Krimi dhe për Financimin e Terrorizmit (CET Nr. 198) (Neni 28 §§ 3 dhe 7, dhe Neni 34 § 2).

### **LIGJI**

#### **I. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 6 TË KONVENTËS**

58. Kërkuesja u ankua për një shkelje të nenit 6 të Konventës, pjesët përkatëse të së cilës parashikojnë si më poshtë:

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile...”

#### **A. Parashtrimet e palëve**

##### *1. Kërkuesja*

##### **a) Zbatueshmëria e nenit 6**

59. Kërkuesja argumentoi se neni 6 ishte i zbatueshëm për procedurat vendëse, në aspektin civil dhe atë penal (krahaso *Xboxhaj kundër Shqipërisë*, nr. 15227/19, § 235, 9 shkurt 2021), dhe deklaroi se organet e *vetting*-ut kryenin një funksion gjyqësor dhe ishin “gjykata” sipas interpretimit të atij neni.

##### **b) Pavarësia dhe paanshmëria**

60. Kërkuesja kundërshtoi në lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë e organeve të *vetting*-ut, në tërësi dhe, veçanërisht, për sa upërket trupave gjyqësore në çështjen e saj. Ajo argumentoi se anëtarët e tyre nuk i nënshtroheshin ndonjë forme *vetting*-u, se mandati i tyre ishte i kufizuar në kohë dhe se nuk ekzistonte ndonjë njohje formale për mosndryshimin e tyre. Ata ishin të ekspozuar ndaj presionit politik dhe merrnin një “bonus për performancën” të posaçëm vetëm një herë. Trupat gjyqësor në çështjen e saj nuk kishte në përbërje dikë që të kishte mbajtur një pozicion në gjyqësor ose të kishte eksperiencën dhe ekspertizën e mjaftueshme profesionale për të trajtuar çështjet faktike dhe ligjore që kishin dalë në këtë çështje. Një anëtar i trupës gjyqësore të KPA-së në çështjen e saj, A.H., ishte diplomuar me një notë mesatare nën mesataren e kërkuar për një anëtar të organit të *vetting*-ut sipas Ligjit të *Vetting*-ut. Një person që ishte pjesë e një trupi gjyqësor të KPA-së (jo në çështjen e saj) ishte ndjekur penalisht (shih *Xboxhaj*, cituar më sipër, §§ 90-92). Trupi gjyqësor i KPK-së kishte kryer hetimin paraprak dhe kishte vendosur për meritat e çështjes. Organet e *vetting*-ut nuk kishin marrë në konsideratë raportin pozitiv të ILDKPKI-së, pa dhënë arsye.

##### **c) Drejtësi**

61. Kërkuesja argumentoi se proceset e *vetting*-ut kishin shkaktuar një mohim flagrant të drejtësisë për arsyet në vijim. Duke mbyllur hetimin vetëm për vlerësimin e pasurisë, organet e *vetting*-ut kishin gjykuar para kohe rezultatin e çështjes, dhe ndërsa ajo u shkarkua pasi nuk kaloi vlerësimin e pasurive, ajo do të mund të ishte konfirmuar në detyrë nëse do të kishte kaluar me sukses në të tria vlerësimet (pasuritë, integriteti dhe aftësia profesionale). Përfundimi se ajo kishte pasuri në një vlerë dyfish më të madhe sesa të ardhurat e saj të ligjshme ishte arritur vetëm me anë të vendimit të datës 20 prill 2018. Një gjë e tillë nuk ishte diskutuar gjatë hetimit ose procedurave përpara KPK-së. Ajo nuk ishte përcaktuar si problematike – që do të thotë, teksa kërkoheshin parashtrimet e kërkueses pas ndryshimit të barrës së provës – në vendimin e datës 13 mars 2018, i cili kishte përmbyllur hetimin. KPA-ja nuk e kishte kompensuar atë të metë të rëndë, duke menduar se ai përfundim kishte nënkuptime në akuzat ndaj saj në fund të hetimit, dhe se ajo duhej ta kishte paraparë këtë gjë. Kjo



kishte rënduar shkeljen, duke ndryshuar në mënyrë radikale gjetjet e KPK-së në vendimin e saj, përsëri duke e gjetur mbrojtjen të papërgatitur (shih më poshtë).

62. Asaj nuk iu lejua të dorëzonte përpara KPA-së prova të tjera shfajësuese për të provuar fakte të caktuara e të rëndësishme dhe elemente ligjore në çështjen kundër saj, se: ajo kishte pasur pronësi reale ndaj ndërtesës së shembur në Lezhë; se vjehrra e saj kishte marrë të ardhura nga shitja e dy trojeve në vitin 2008; se A.M. kishte pasur mjaftueshëm të ardhura për t'i dhënë familjes së saj një hua të vogël për të blerë makinën e tyre të vetme; dhe se në çdo rast, ajo kishte pasur burime legjitime për t'ia kthyer borxhin; dhe se ajo kishte pasur burime financiare për të mbledhur kursime të rëndësishme gjatë viteve, duke pasur në konsideratë shpenzimet familjare për jetesën.

#### **d) Ankesa të tjera**

63. Ankesat e tjera të kërkuases dhe parashtrimet e tjera janë të ngjashme me ato në vendimin *Xboxhaj* (cituar më sipër, §§ 259-65, 318-20, 337 dhe 345).

##### *2. Qeveria*

64. Qeveria argumentoi se aspekti civil në nenin 6 ishte i zbatueshëm në proceset e *vetting*-ut dhe se organet e *vetting*-ut ishin “grykatarë” sipas kuptimit të nenit 6.

65. Kërkuësja nuk kishte dorëzuar pranë organeve të *vetting*-ut ndonjë kërkesë në lidhje me kohën e pamjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen; se ajo nuk kishte kërkuar shtyrje apo kohë shtesë për të studiuar apo sjellë prova. Ajo nuk kishte kërkuar përjashtimin e ndonjërit prej anëtarëve të trupës gjyqësore të KPA-së. Vendimi i tyre për të shqyrtuar apelimin me dyer të mbyllura pa praninë e palëve kishte qenë i ligjshëm dhe i justifikuar.

66. KPA-ja kishte gjykuar se burimet e të ardhurave për krijimin e pasurive të saj nuk ishin qartësuar me anë të provave dokumentare të parashikuara nga legjislacioni. Kërkuësja dhe bashkëshorti i saj kishin vepruar si pronarët legjitimë të apartamentit në Lezhë edhe pse nuk kishin pasur të drejtë ligjore për të pretenduar se ai apartament ishte pronë e tyre. Në këtë mënyrë, ajo nuk kishte provuar ligjshmërinë e burimit të përdorur për krijimin e pasurive të saj, sipas parashikimit të nenit 32(4) të Ligjit për *Vetting*-ut. Kërkuësja nuk kishte pasur burime të mjaftueshme për t'i përfutur ato dhe kishte bërë deklaratë të rreme.

67. Parashtrimet e Qeverisë janë thelbësisht të ngjashme me ato në vendimin *Xboxhaj* (cituar më sipër, §§ 266-69, 321-23, 338 dhe 346-47).

##### *3. Palët e treta*

68. Parashtrimet e palëve të treta janë të përmbledhura në vendimin *Xboxhaj* (cituar më sipër, §§ 270-79).

69. Në vendimin *Xboxhaj* (cituar më sipër, §§ 236-46), Grykatarë vendosi se aspekti civil i nenit 6 ishte i zbatueshëm në procedurat e *vetting*-ut, por aspekti penal nuk ishte i zbatueshëm. Duke pasur në konsideratë zbatueshmërinë e aspektit civil dhe mungesën e vërtetueshmërisë në lidhje me aspektin penal, Grykatarë do të vlerësojë vetëm, ashtu si në *Xboxhaj*, ankesën e kërkuases duke iu referuar aspektit civil të nenit 6.

70. Në *Xboxhaj* (cituar më sipër, §§ 284-86), Grykatarë shprehej se organet e *vetting*-ut ishin “grykatarë” sipas interpretimit të nenit 6 § 1. Grykatarë nuk gjen arsye të gjykojë ndryshe në çështjen konkrete.

##### *1. Pavarësia dhe paanshmëria*

71. Nocioni “grykatarë” nënkupton se ajo duhet të përbëhet nga gjyqtarë të përzgjedhur mbi bazë të meritës – që do të thotë, gjyqtarë të cilët përmbushin kërkesat e kompetencës teknike dhe të integritetit moral për të kryer funksionet gjyqësore të kërkuara prej saj në një shtet të drejtuar nga shteti i së drejtës (shih *Guðmundur Andri Astráðsson kundër Islandës* [DHM], nr. 26374/18, §§ 220-21, 1 dhjetor 2020). Një proces rigoroz për emërimin e gjyqtarëve të zakonshëm është i një rëndësie kryesore për të garantuar se në postet gjyqësore emërohen kandidatët më të kualifikuar në të dy këto

aspekte. Sa më lart të pozicionohet një “gjykatë” në hierarkinë gjyqësore, aq më kërkuese duhet të jenë kriteret e zbatueshme për përzgjedhjen. Një përzgjedhje e tillë e mbështetur në meritë jo vetëm që garanton kapacitetin teknik të një organi gjyqësor për dhënien e drejtësisë si “gjykatë”, por është thelbësore edhe në termat e garantimit të sigurisë së publikut në gjyqësor dhe shërben si një garanci shtesë për pavarësinë personale të gjyqtarëve (ibid., § 222). Duke marrë në konsideratë gjetjet në vendimin *Xboxhaj* (cituar më sipër, §§ 295-304), Gjykata vendos se mënyra e përzgjedhjes dhe e emërimit të anëtarëve të trupit gjykues të KPK-së në çështjen e kërkueses nuk paraqiste, *per se*, një shkelje të kërkesave për pavarësi ose paanshmëri objektive.

72. Fillimisht, Gjykata u referohet gjetjeve të saj në *Xboxhaj* (ibid., §§ 305-08), në lidhje me kërkesën për paanshmëri objektive. Ndryshe nga procedurat e zakonshme disiplinore, procedurat e *vetting*-ut nuk fillonin me depozitimin e një ankese ose me një akuzë për sjellje të keqe. Si rezultat i veprimit automatik të Ligjit të *Vetting*-ut, KPK-ja nisi një hetim për tri deklaratimet e depozituara nga kërkuesja në vend që të mbështetej në gjetjet e saj për nisjen e procedurave disiplinore ndaj saj. Trupi gjykues i KPK-së nuk mori rolin e një prokurori duke mos ngritur akuza ndaj saj. Në këtë mënyrë, detyrat e këtij trupi gjykues kufizoheshin vetëm në rivlerësim mbështetur në kriteret e parashikuara në aneksin e Kushtetutës dhe në Ligjin e *Vetting*-ut. Prandaj, ekzistonte konfuzion midis detyrimit statutor të KPK-së për të nisur një hetim, në të cilin nuk u ngrit asnjë akuzë apo gjetje për shkelje ndaj kërkueses, dhe detyrës së tij për të marrë një vendim për përgjegjësinë e saj disiplinore. Fakti se KPK-ja paraqiti gjetje paraprake nuk ishte mjaftueshëm për të nxitur pasiguri objektivist të justifikuar për anshmërinë e tij. Sipas Gjykatës, e njëjta linjë arsyetimi qëndron e vërtetë në çështjen konkrete.

## 2. Drejtësia

73. Gjykata vëren se, ndryshe nga *Xboxhaj*, në çështjen konkrete, KPK-ja ndoqi dhe përfundoi vetëm hetimet paraprake në lidhje me vlerësimin e pasurive, dhe më pas vendosi mbështetur në meritat e çështjes, pa u kaluar te kontrolli i figurës dhe vlerësimi i kompetencës profesionale. Një gjë e tillë ishte në linjë me Ligjin e *Vetting*-ut sipas interpretimit të KPA-së. Sipas Gjykatës, një qasje e tillë nuk shkaktonte, *per se*, një shkelje të së drejtës së kërkueses për një gjykim të drejtë.

74. Mbetet i pakundërshtuar fakti se pasuritë kryesore që ishin subjekt i vlerësimit dhe që u përcaktuan si problematike ishin të njëjtat në të gjitha fazat e procedurave pranë KPK-së, siç pohohej edhe në vendimet e datave 13 mars dhe 20 prill 2018. Baza ligjore (specifikisht, neni D § 3 i Aneksit të Kushtetutës, cituar në paragrafin 27 më sipër), argumentet dhe arsyet kryesore ligjore për të cilat fillimisht ato u morën në shqyrtim dhe më pas u gjykuan nga KPK-ja si problematike, mbetën kryesisht të njëjtat.

75. Neni 4(6) i Ligjit të *Vetting*-ut, së bashku me nenin 47 të Ligjit për Gjykatat Administrative, parashikon bazën ligjore për trajtimin e (pranimin e) provave rreth apelimit (shih paragrafët 28 dhe 45 më sipër). Nuk ekziston asnjë tregues se kërkuesja nuk kishte pasur mundësi të paraqiste, ose ndryshe ishte ndaluar të paraqiste prova të caktuara tashmë në procedurat pranë KPK-së. Sipas rrethanave të çështjes, Gjykata gjykon se mënyra me të cilën KPA-ja trajtoi provat nuk shkelte nenin 6 § 1 të Konventës. Në çdo rast, KPA-ja sqaroi se provat e reja të propozuara nuk do të kishin ndonjë ndikim vendimtar në rezultatin e çështjes.

76. Veçanërisht, si gjatë hetimit paraprak dhe gjatë procedurave të mëtejshme në KPK, kërkuesja ishte në dijeni për kërkesën për të paraqitur të dhëna me datën kur ajo (ose bashkëshorti i saj) kishte marrë të ardhurat nga shitja e trojeve, të cilat ishin deklaruar nga ajo se ishin përdorur për të marrë një apartament në Tiranë (shih paragrafët 7 dhe 10 më sipër). Në këtë aspekt, përpjekja e saj e mëpasshme për të sjellë prova shtesë në lidhje me datën në të cilën vjehrra e saj kishte marrë ato para nuk dukej se do të kishte ndikim mbi problematikat përkatëse faktike dhe ligjore të përcaktuara nga organet e *vetting*-ut, veçanërisht në nivel apeli. Po kështu, gjatë hetimit paraprak, kërkuesja ishte

në dijeni për kërkesën sipas së cilës ajo duhej të provonte pronësinë e pronës së shkatërruar, kompensimin e përdorur, sipas saj, për të përvetësuar një tjetër pronë të përmendur në deklarin e *vetting*-ut. Kur kërkesja i përcaktoi, disi gjerësisht, kursimet e saj dhe kursimet familjare si burimin e përdorur për të përfutur pasuritë e paraqitura në atë deklarin ose për të përmbushur detyrimet pasurore, të tilla si ato për një hua private, duke qenë se ajo ishte një profesioniste me eksperiencë në fushën ligjore, ajo do të duhej të kishte kuptuar se ishte e rëndësishme, që sipas nenit D të aneksit të Kushtetutës, të provonte kapacitetin e saj dhe të familjes së saj për t'i akumuluar këto kursime në mënyrën dhe në shumën e specifikuar prej saj në deklarin e *vetting*-ut. Nuk ka indicie se ajo nuk kishte pasur mundësi, ose ishte penguar që të paraqiste të gjitha provat përkatëse që tashmë ishin përpara KPK-së, veçanërisht pasi ishte njoftuar se barra e provës kishte kaluar tek ajo.

77. Gjithashtu, kërkesja nuk e ka provuar pretendimin e saj se mënyra me të cilën ishin kryer procedurat e *vetting*-ut ishte, për sa ka të bëjë me nenin 6, arbitrare dhe ndiqte një qëllim të mëtejshëm për përndjekjen e saj, kryesisht, për bindjet dhe aktivitetet politike të bashkëshortit të saj (krahaso *Xboxhaj*, cituar më sipër, § 296; *Navalnyy dhe Ofitserov kundër Rusisë*, nr. 46632/13 dhe 28671/14, § 129, 23 shkurt 2016, *Navalnyye kundër Rusisë*, nr. 101/15, § 88, 17 tetor 2017; dhe *Nevezlin kundër Rusisë*, nr. 26679/08, §§ 124-25, 18 janar 2022, në kontekstin e ankesës sipas nenit 18 të Konventës).

### 3. Përfundim

78. Për sa ka të bëjë me ankesat e tjera, pasi ka shqyrtuar parashtrimet e palëve, Gjykata gjykon se kërkesja nuk i ka provuar ato dhe as nuk ka ngritur ndonjë argument meritore. Gjykata nuk konstaton asnjë arsye për të mos marrë në konsideratë gjetjet e saj përkatëse të *Xboxhaj* (cituar më sipër, §§ 283-88, 294-317, 328-36, 341-44 dhe 348-53).

79. Konstatimet e mësipërme janë të mjaftueshme për t'i mundësuar Gjykatës të arrijë në përfundimin se ankesat e kërkeses, siç janë paraqitur dhe provuar në çështjen konkrete, nuk janë të mbështetura në fakte. Në këtë mënyrë, ato duhet të rrezohen në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

## II. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 8 TË KONVENTËS

80. Kërkesja u ankua se ishte shkelur neni 8 i Konventës, për shkak të shkarkimit të saj nga detyra dhe vendimit që e ndalonte atë të praktikonte ligjin si avokate.

81. Pjesët përkatëse të nenit 8 parashikojnë si më poshtë:

“1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private...”

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve”

### A. Qëllimi i ankesës përpara Gjykatës

82. Qëllimi i çështjes “referuar në” Gjykatë në ushtrimin e së drejtës për kërkesë individuale përcaktohet nga ankesa e kërkeses. Një ankesë përbëhet nga dy elemente: pretendimet faktike dhe argumentet ligjore. Sipas parimit *jura novit curia*, referuar shkaqeve ligjore të paraqitura nga kërkesja sipas Konventës dhe Protokolleve të saj, Gjykata nuk gjen lidhje me çështjen, dhe ka fuqinë të vendosë për karakterizimin që do të jepet sipas ligjit për faktet e ankesës, duke e shqyrtuar atë sipas neneve dhe parashikimeve të Konventës që janë ndryshe nga ato mbi të cilat mbështetet kërkesja. Megjithatë, ajo nuk mund ta mbështesë vendimin e saj mbi fakte që nuk janë trajtuar nga ankesa. Për ta bërë një gjë të tillë, do të ishte njëllor sikur të merrej një vendim përtej qëllimit të çështjes; me fjalë të tjera, të vendosej mbi çështje që nuk “referohen” sipas interpretimit të nenit 32 të Konventës (shih *Radomilja dhe të Tjerët kundër Kroacisë* [DHM], nr. 37685/10, dhe 22768/12, § 126, 20 mars 2018, dhe *Udaltsov kundër Rusisë*, nr. 76695/11, § 186, 6 tetor 2020).

83. Në kërkesën e saj në Gjykatë, në muajin dhjetor 2018, kërkuësja ngriti dy ankesa, sipas nenit 8 të Konventës: i. për proceset e *vetting*-ut dhe rezultatit e tyre të drejtpërdrejtë, që do të thotë, shkarkimin e saj nga detyra; dhe ii. për ndalimin – që pretendohet se ngrihet sipas legjislacionit të zbatueshëm – që të praktikonte ligjin si avokate private, pas shkarkimit të saj nga detyra. Për këtë ankesë të dytë, në vitin 2020, ajo bëri me dije Gjykatën për korrespondencën e saj me Dhomën Kombëtare të Avokatisë për këtë çështje në muajin nëntor 2018 (shih paragrafin 23 më sipër).

84. Rezulton se qëllimi i ankesës përpara Gjykatës është i kufizuar vetëm te procedurat e *vetting*-ut që rezultuan në vendimin e KPA-së më datë 12 shtator 2018, dhe në ndalimin e mëpasshëm të kërkuësës që të ushtrojë ligjin si avokate (anëtare e Shoqatës së Avokatëve).

## **B. Pranueshmëria**

### *1. Në lidhje me shkarkimin e kërkuësës nga detyra*

85. Ashtu si në vendimin *Xboxhaj* (cituat më sipër, § 356), Qeveria argumentoi se ankesa nuk përputhej *ratione materiae* me parashikimet e Konventës dhe se kërkuësja nuk kishte shteruar zgjidhjet vendëse. Kërkuësja nuk ra dakord.

86. Për arsyet e përmendura në *Xboxhaj* (ibid., §§ 362-67), Gjykata i rrëzon argumentet e Qeverisë dhe gjykon se kjo ankesë nuk është as e pambështetur në fakte dhe as e papranueshme për ndonjë arsye tjetër listuar në nenin 35 të Konventës. Për këtë arsye, ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

### *2. Në lidhje me ndalimin e kërkuësës për të ushtruar ligjin*

87. Kërkuësja argumentoi se shkarkimi i saj nga detyra në procedurat e *vetting*-ut kishte rezultuar në vendimin për ndalimin e saj në ushtrimin e ligjit si “avokate”, sipas legjislacionit shqiptar. Në janar 2020, ajo bëri me dije Gjykatën, se në 9 nëntor 2018, kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatisë kishte rrëzuar kërkesën e saj për t’u regjistruar si avokate, për shkak të shkarkimit të saj si rezultat i procedurave të *vetting*-ut (shih paragrafin 23 më sipër). Sipas saj, ajo përgjigje provonte pa mëdyshje se ndalimi ekzistonte dhe ishte urdhëruar të zbatohet. Ajo nuk to të kishte kurrë mundësi të ushtronte ligjin si avokate private, që nënkupton se mundësitë për të që të mund të gjente punësim në fushën ligjore në përputhje me kualifikimet dhe eksperiencën e saj profesionale ishin reduktuar në masën që e bënte të pamundur ushtrimin e profesionit të saj.

88. Si përgjigje ndaj parashtrimeve të kërkuësës në vitin 2020, Qeveria deklaroi se shkresa e datës 9 nëntor 2018 ishte përgjigje për kërkesën e saj për informacione në lidhje me legjislacionin e zbatueshëm dhe nuk kishte lidhje me ankesën e saj përpara Gjykatës për procedurat e *vetting*-ut. Kufizimet në ushtrimin e ligjit si avokate nuk kishin ardhur si rezultat i procedurës së *vetting*-ut. Në çdo rast, nëse shkresa e kundërshtuar do të merrej në konsideratë për një vendim, kërkuësja nuk kishte shteruar zgjidhjet vendëse duke kërkuar një proces në gjykatën administrative në mbështetje të Ligjit për Gjykatat Administrative.

89. Në *Xboxhaj*, Gjykata shprehej si më poshtë:

“371. Në lidhje me çështjen në fjalë, Gjykata vëren se proceset ishin të udhëhequra dhe përfunduan në zbatim të ligjit nr. 84/2016. Institucionet e rivlerësimit nuk morën asnjë vendim në lidhje me të drejtën e kërkuësës për të ushtruar profesionin e avokatit; ata nuk bënë as ndonjë referencë, qoftë edhe në mënyrë të nënkuptuar, në dispozitat e ligjit për avokatinë. Për më shumë, kërkuësja pohoi se ajo kishte një licencë për të ushtruar profesionin e avokatit. Në këto rrethana, Gjykata vëren se ajo nuk mund të pretendojë të jetë viktimë e shkeljes së të drejtave të saj sipas nenit 8 të Konventës.

372. Fakti që kërkuësja pretendon se mund të bëhet viktimë e mundshme në të ardhmen për shkak të rrezikut të heqjes të së drejtës së avokatisë, në përputhje me ligjin për avokatinë (shih paragrafin 208 më lart), është thjesht një dyshim ose hamendësim nga ana e saj. Deri më sot ajo nuk është prekur nga një vendim i pafavorshëm individual i marrë kundër saj. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, ajo është e lirë që të kundërshtojë përpara një gjykate çdo vendim të pafavorshëm që

Dhoma e Avokatisë mund të marrë kundër saj në të ardhmen, dhe kështu t'i sigurojë shtetit të paditur mundësinë për të korrigjuar çdo shkelje të pretenduar të të drejtave të saj, sipas Konventës, siç kërkohet nga neni 35/1 i Konventës. Për më shumë, kërkuesja nuk tregoi që fusha e zbatimit e ligjit për avokatinë ishte drejtuar posaçërisht kundër gjyqtarëve ose prokurorëve ndaj të cilëve ishte dhënë një vendim gjatë procesit të rivlerësimit (për krahasim dhe në kontrast *Tănase*, cituar më lart, dhe *Sejdić dhe Finći kundër Bosnjës dhe Hercegovinës* [DHM], nr. 27996/06 dhe 34836/06, GJEDNJ 2009). Për ta përmbledhur, kërkueses nuk do t'i kërkohej që të modifikojë ndonjë sjellje sipas ligjit për avokatinë; ajo do t'u nënshtrohej kërkesave ligjore të këtij ligji.”

90. Kërkuesja nuk ka paraqitur pranë Gjykatës një kopje të korrespondencës së saj me Dhomën Kombëtare të Avokatisë, por vetëm kishte deklaruar se ajo kishte për qëllim të “regjistrohej” si avokate. Rezulton se, të paktën në muajin nëntor 2018, ajo nuk kishte licencën për të ushtruar ligjin si “avokate”, sipas interpretimit të Ligjit për Avokatinë (shih paragrafët 46-48 më sipër).

91. Përveç disa referencave në legjislacion, shkresa e datës 9 nëntor 2018, e nënshkruar nga kryetari i Dhomës, përmbante gjetje në lidhje me kërkuesen dhe situatën e saj specifike si rezultat i procedurave të *vetting*-ut. Megjithatë, mbetet e paqartë nëse ajo shkresë ishte një përgjigje formale, brenda asaj zone kompetence sipas Statutit të Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, apo ndonjë legjislacioni të zbatueshëm, për një kërkesë specifike e tillë si kërkesa për t'u regjistruar. Nëse vendimi për kundërshtimin e kërkesës së kërkueses konsiderohet formal, është e pranueshme që ajo shkresë do të merrej për shqyrtim, sipas ligjit shqiptar, për shembull, sipas Ligjit për Avokatinë dhe/ose Ligjin për Gjykatat Administrative, siç sugjerohet nga Qeveria. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë se dispozitat përkatëse të Ligjit për Avokatinë, që në këtë çështje u cituan si baza ligjore për atë që përbënte një ndërhyrje në të drejtat e saj sipas nenit 8 të Konventës, u testuan me anë të shqyrtimit kushtetues (krahaso, *mutatis mutandis*, *Fullani kundër Shqipërisë* (vendim), nr. 4586/18, §§ 78-80, 20 Shtator 2022). Në çështjen konkrete, Gjykata nuk ka nevojë të bëjë konstatime të tjera për shterimin e problematikës sepse, në çdo rast, nuk është provuar se ai dokument përbënte një vendim personalisht dhe duke ndikuar negativisht qëllimin e kërkueses *vis-a-vis* për të ushtruar ligjin jashtë sistemit të drejtësisë, për shembull, në sektorin privat. Kërkuesja nuk ka marrë hapa për të kundërshtuar ndalimin e saj të supozuar nga e drejta për t'u bashkuar Shoqatës së Avokatëve.

92. Sipas rrethanave të çështjes konkrete, Gjykata është e mendimit se kjo ankesë është e papajtueshme *ratione personae* me parashikimet e Konventës dhe duhet të rrëzohet në përputhje me Nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4.

### **C. Meritat**

93. Ka pasur ndërhyrje në të drejtën e kërkueses për respektimin e jetës së saj private, për shkak të shkarkimit të saj nga detyra (shih *Xboxhaj*, cituar më sipër, §§ 363-64 dhe 377). Një ndërhyrje në të drejtën e personit për respektimin e jetës private do të jetë shkelje e nenit 8 § 2, për të qenë “në përputhje me ligjin”, sipas një ose më shumë qëllimeve legjitime të listuara në të, dhe duke qenë “i nevojshëm në një shoqëri demokratike” për të arritur qëllimin ose qëllimet përkatëse.

1. Nëse ndërhyrja ishte “në përputhje me ligjin”

#### **a) Parashtrimet e palëve**

*i. Kërkuesja*

94. Kërkuesja parashtrori se vendimi për ta shkarkuar nga detyra nuk kishte qenë në përputhje me ligjin shqiptar, për arsyet e përmbledhura në paragrafët 60-63 më sipër. Ligji i *Vetting*-ut ishte shprehur në terma të gjerë dhe të paqartë, pa përmbushur kërkesën e parashikueshmërisë, veçanërisht sepse ligji vendës nuk përcaktonte rrethanat të cilat do të përbënin arsyet për shkarkimin nga detyra. Në lidhje me vlerësimin e pasurive, ishte e paqartë se çfarë lloji mospërputhje apo mangësie arrinte nivelin e kërkuar për të qenë e rëndë për të justifikuar shkarkimin. Organet e *vetting*-ut gëzonin diskrecion të papenguar në interpretimin e parashikimeve dhe vlerësimin e rrethanave të

çështjes, dhe se fundmi, në marrjen e vendimit nëse një individ duhej të shkarkohej. Mungesa e udhëzimeve e bënte diskrecionin e organeve të *vetting*-ut të hapur dhe dëmtonte parimin e sigurisë ligjore. Pothuajse çdo shkelje nga një prokuror ose mospërputhje me deklarin fillstar (pavarësisht sesa i vogël dhe i parëndësishëm) mund të merrej nga organet e *vetting*-ut si bazë e mjaftueshme ligjore për një “akuzë” serioze në kontekstin e procesit të *vetting*-ut dhe mund të rezultonte në shkarkimin nga detyra.

#### *ii. Qeveria*

95. Qeveria parashtroi se dispozitat në Ligjin e *Vetting*-ut ishin të qarta, të mirëpërcaktuara dhe të detajuara. Ligji nuk përmbante ndonjë kontradiktë dhe parashikonte sigurinë, qartësinë dhe vijimësinë. Koncepti i ligjshmërisë së pasurisë ishte i dukshëm në ligjin vendës, si në statute në lidhje me deklarin e pasurive ose në parandalimin e pastrimit të parave. Në mënyrë që një pasuri të konsiderohej e ligjshme, duhej të përmbusheshin dy kushte: të ardhurat e përdorura për krijimin ose përfundimin e pasurisë duhej të vinin nga një aktivitet i ligjshëm, dhe të ardhurat duhej t'i ishin nënshtruar pagesës së tatimeve dhe detyrimeve të zbatueshme. Përmbushja kumulative e këtyre dy kushteve parashikohej qartazi në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 3 të Ligjit të *Vetting*-ut.

96. Baza për konstatimin e deklarin të pamjaftueshëm të pasurive ishte deklarimi i *vetting*-ut të pasurive. Sipas nenit 61(3) të Ligjit të *Vetting*-ut, se bashku me nenin 33, deklarimi i pasurive do të ishte i pamjaftueshëm, nëse ishte konstatuar se kishte mungesë të burimeve financiare, fshehje të pasurive, deklarim të rremë të pasurive ose një konflikt interesi. Deklarimet e mëparshme të pasurive mund të përdoren si prova nga organet e *vetting*-ut.

97. Shpenzimet për jetesën përlogaritëshin duke iu referuar deklarin të një individi, të dhënave të marra nga organet e *vetting*-ut nga institucionet kombëtare dhe të huaja, deklarimet e mëparshme dhe provat e mbledhura nga institucionet bankare dhe jo bankare. Prova të tilla do t'u nënshtroheshin procedurave akuzuese, si rezultat i të cilave personi i vetuar/rivlerësuar do të ftohej të paraqiste provat e tij ose të saj në mbështetje të pozicionit të tij ose saj. Të gjitha provat do t'u nënshtroheshin kontrolleve numerike dhe logjike dhe KPK-ja do të merrte një vendim të individualizuar për secilën çështje, në lidhje me faktet specifike.

#### **b) Vlerësimi i Gjykatës**

98. Shprehja “në përputhje me ligjin” kërkon që masa e kundërshtuar duhet të mbështetet në ligjin vendës, dhe se ligji konkret duhet të jetë i aksesueshëm për personin e përfshirë dhe i parashikueshëm për pasojat e tij (shih midis autoriteteve të tjerë, *Fernandez Martinez kundër Spanjës* [DHM], nr. 56030/07, § 117, GJEDNJ 2014 (ekstrakte)). Në mënyrë që ligji të përmbushë kërkesat e parashikueshmërisë, ai duhet të parashikojë me saktësi të mjaftueshme kushtet në të cilat mund të zbatohet një masë, për t'i bërë të mundur personave konkretë – nëse do të ishte e nevojshme, me këshillimin e duhur – të rregullonin sjelljen e tyre (shih midis autoriteteve të tjera, *Altay kundër Turqisë* (nr. 2), nr. 11236/09, § 54, 9 prill 2019).

99. Vendimi për të shkarkuar kërkuesen nga detyra ë vitin 2018 kishte bazë ligjore në nenin 61(1) dhe (3) të Ligjit të *Vetting*-ut të hyrë në fuqi në vitin 2016; dhe për sa ka të bëjë me çështjen organet e *vetting*-ut arritën në përfundimin për deklarin e saj të *vetting*-ut të vitit 2017 për pasuritë, se ajo: i. kishte deklaruar një total pasurish më të madh sesa dyfishi i vlerës së pasurisë të përfunduar në mënyrë të ligjshme; dhe ii. nuk kishte bërë deklarim të mjaftueshëm për pasuritë sipas nenit 33 të Ligjit. Dispozita e fundit listonte parametrat për vlerësimin e deklarin, ku kërkohej që ajo të ishte e saktë, në përputhje me ligjin, e mbështetur me burime të ligjshme financiare, dhe të kishte burime financiare të mjaftueshme dhe të ligjshme për të justifikuar pasuritë, pa fshehje të pasurive dhe pa deklarime të rreme.

100. Që nga hyrja në fuqi të Ligjit për Deklarimin e Pasurive në vitin 2003 dhe deri në momentin kur kërkuesja paraqiti deklarinin e saj të *vetting*-ut në vitin 2017 sipas Ligjit për *Vetting*-un, asaj i ishte kërkuar që të paraqiste deklarime vjetore për interesat privatë, burimet e përdorura për krijimin e tyre, si edhe në lidhje me detyrimet financiare për, *inter alia*, pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat ndaj tyre, pasuritë e luajtshme, detyrimet financiare ndaj personave të tjerë, të ardhurat personale dhe shpenzimet e deklarueshme (shih paragrafin 24 më sipër). Në procesin e *vetting*-ut, vlerësimi i pasurive përfshinte edhe deklarinin dhe kontrollin e pasurive, ligjshmërinë e burimit të përdorur për përfundimin ose krijimin e tyre, përmbushjen e detyrimeve financiare, duke përfshirë interesat privatë të personit të rivlerësuar dhe personave të lidhur me të (shih paragrafin 29 më sipër). Organet e *vetting*-ut mund të përdornin dhe përdorën si prova deklarimet vjetore të pasurive të përmendura më sipër (shih paragrafin 30 më sipër).

101. Në fillim të procesit të *vetting*-ut, kërkueses iu kërkuar të paraqiste dokumente mbështetëse me anë të të cilave të justifikonte vërtetësinë e deklarimeve të saj në deklarinin e *vetting*-ut, në lidhje me ligjshmërinë e burimeve të përdorura për krijimin e pasurive (shih paragrafin 30 më sipër). Sipas nenit D § 3 të Aneksit të Kushtetutës, ajo duhej të ofronte shpjegime bindëse në lidhje me ligjshmërinë e burimit të pasurive dhe të ardhurave; pasuritë do të konsideroheshin të ligjshme nëse të ardhurat ishin deklaruar dhe për to ishte paguar tatimi (shih paragrafin 27 më sipër).

102. Sipas Ligjit të *Vetting*-ut, vlerësimi i pasurive dhe një vendim i lidhur me të për shkarkim nga detyra – veçanërisht kur zbatohet neni D § 4 i Aneksit të Kushtetutës, si në çështjen konkrete – i nënshtrohen kërkesës për proporcionalitet (shih paragrafët 28 dhe 34 më sipër), mund të hamendësohet se vetëm problematikat relativisht të rënda mund të merren në konsideratë për të justifikuar sanksionin përfundimtar për shkarkim nga detyra. Gjithashtu, mosdeklarimi i saktë i pasurive kishte qenë vepër penale përpara vitit 2016 (shih paragrafin 25 më sipër).

103. Gjykata arrin në përfundimin se kërkuesja nuk e kishte provuar pretendimin e saj se kishte mungesë të parashikueshmërisë në lidhje me arsyet për shkarkimin e saj nga detyra.

104. Së fundmi, theksohet se ankesa e kërkueses në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës është i pambështetur në fakte (shih paragrafët 60–63 dhe 78–79 më sipër). Në çështjen konkrete, Gjykata nuk gjykon se ndërhyrja sipas nenit 8 të Konventës nuk ishte në “në përputhje me ligjin” mbështetur në rrethanat përmendur në atë ankesë.

105. Gjykata arrin në përfundimin se ndërhyrja në të drejtën e kërkueses për respektimin e jetës private ishte në përputhje me ligjin, sipas parashikimit në nenin 8 §§ 2 të Konventës (shih, në të njëjtën linjë, *Xboxhaj*, cituar më sipër, §§ 385–86).

## 2. Nëse ndërhyrja ndiqte një qëllim legjitim

106. Kërkuesja shprehu kundërshtim pasi ndërhyrja nuk kishte ndjekur ndonjë qëllim legjitim. Qëllimi legjitim i paraqitur nga parashtrimet e Qeverisë, më konkretisht pastrimi i gjyqësorit nga korrupsioni, mund të ishte arritur me anë të mjeteve më pak ndërhyrëse, të tilla si trajnim i detyruar. Komisioni Evropian nuk kishte bërë thirrje për një *vetting* të gjerë në radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë për të zhdukur korrupsionin.

107. Qeveria parashtroi, duke iu referuar raportit për vlerësimin e sistemit gjyqësor në Shqipëri (shih *Xboxhaj*, cituar më sipër, §§ 4 dhe 390) se ishin identifikuar një sërë problemesh. Këto probleme kishin ngritur nevojën për të bërë ndryshime strukturore, të cilat kishin kulmuar me ndryshimet kushtetuese dhe miratimin e një grupi statutesh të rëndësishëm. Qeveria iu referua qëllimeve legjitime të cilat i kishte identifikuar Gjykata Kushtetuese në shqyrtimin kushtetues të Ligjit të *Vetting*-ut.

108. Duke iu referuar gjetjeve në *Xboxhaj* (cituar më sipër, § 393) dhe statusit të prokurorëve në sistemin e drejtësisë në Shqipëri (shih paragrafët 36–38 më sipër), Gjykata nuk gjen arsye të dyshojë se qëllimi i ndjekur nga Ligji i *Vetting*-ut në përgjithësi, dhe ndërhyrja në çështjen konkrete (*vetting*-u i

një prokuroreje) ishte në të njëjtën linjë me qëllimet e identifikuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe në interesat e sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve, siç parashikon neni 8 § 2 i Konventës.

3. Nëse ndërhyrja ishte “e nevojshme në një shtet demokratik”

#### a) Parashtrimet e palëve

##### i. Kërkesja

109. Organet e *vetting*-ut kishin shkelur kufijtë e përcaktuar nga Ligji i *Vetting*-ut dhe e kishin shkarkuar atë nga detyra duke iu referuar deklarimeve të saj vjetore për pasuritë, të cilat i kishte depozituar pranë Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, dhe për të cilat ishte dhënë një vlerësim pozitiv. Nuk kishte asnjë mbrojtje procedurale për të parandaluar zbatimin arbitrar të ligjit. Legjislacioni nuk parashikonte shkallën e duhur të sanksioneve për shkeljet disiplinore, dhe nuk ishte përpunuar asnjë rregull për të garantuar zbatimin e tyre në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

110. Si rezultat i procedurave të *vetting*-ut, ajo ishte stigmatizuar si një person i pavlerë për të kryer funksionet e saj, duke u mbështetur në mospërputhshmëritë e pretenduara në pasuritë e saj dhe në mundësinë e supozuar se rrezikohej besimi i publikut nën gjyqësor. Ajo kishte qenë në kulmin e karrierës së saj si rezultat i shumë viteve dedikimi personal dhe angazhimi profesional si prokurore. Reputacioni, nderi dhe karriera e saj kishin pësuar një goditje të pakorrigjueshme, edhe për shkak të fushatës masive mediatike kundër saj. Ajo jo vetëm që ishte shkarkuar nga detyra si prokurore, por edhe ishte ndaluar nga ushtrimi i funksioneve publike, teksa mundësitë për të gjetur një punë në fushën ligjore në përputhje me kualifikimet dhe eksperiencën e saj ishin reduktuar në atë masë që e bënte ushtrimin e profesionit të saj pothuajse të pamundur.

111. Shkarkim i saj nga detyra ishte shpërpjesëtimor me qëllimin e ndjekur dhe me shkeljen mbi të cilin ishte mbështetur. Legjislacioni nuk përmbante rregulla që garantonin se sanksioni i shkarkimit nga detyra zbatohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Veçanërisht, legjislacioni nuk parashikonte normën e duhur të sanksioneve për veprat disiplinore, dhe nuk ishin nxjerrë rregulla për garantimin e zbatimit të tyre në përputhje me atë parim. Sipas nenit 58 të Ligjit të *Vetting*-ut, rezultatet e vetme të mundshme të procesit të *vetting*-ut ishin konfirmimi në detyrë, pezullimi nga detyra për një vit dhe shkarkimi nga detyra. Dy llojet e sanksioneve linin pak vend për të disiplinuar një prokuror në mënyrë proporcionale. Autoritetet e *vetting*-ut iu ishin dhënë mundësi të kufizuara për të balancuar interesat konkurrues të publikë dhe individualë në secilin rast.

112. Arsytet e paraqitura nga KPK-ja nuk ishin të duhurat ose të mjaftueshme për të justifikuar një masë të tillë drakoniane si shkarkimi nga detyra. Mospërputhshmëritë e pretenduara te pasuritë e saj nuk kishin qenë të një natyre aq themelore që të mund ose që duhej të kishin nxitur shkarkimin e saj nga detyra. KPK-ja e kishte shkarkuar nga detyra kryesisht për arsytet e mëposhtme: nuk kishte listuar në deklarin e saj të *vetting*-ut dy garazhe (edhe pse pronësia ishte provuar nga marrëveshja e blerjes bashkëngjitur me deklarin, dhe fakti se ajo i kishte përmendur garazhet në deklarinet periodike vjetore); nuk kishte provuar se në vitin 2008 vjehrra e saj i kishte dhënë familjes së saj 752,800 lekë (6,000 euro) për blerjen e apartamentit në Tiranë (edhe pse vjehrra e saj kishte bërë një deklaratë nën betim ku e konfirmonte këtë gjë dhe pavarësisht se kërkesja e kishte deklaruar atë dhuratë në deklarinet periodike vjetore që në vitin 2008); nuk kishte provuar pronësinë e apartamentit të shkatërruar në Lezhë që ishte blerë në vitin 1998 (edhe pse ajo kishte dorëzuar një kopje të marrëveshjes noteriale nënshkruar në vitin 2011 midis një kompanie ndërtimi dhe bashkëshortit të saj, ku përcaktoheshin kushtet e kompensimit për apartamentin e shembur); dhe nuk kishte provuar se një mik i bashkëshortit të saj kishte pasur mjaftueshëm të ardhura për t'i dhënë atyre një hua të vogël për blerjen e një automjeti të përdorur. Arsytet e dhëna nga organet e *vetting*-ut ishin dukshëm të pamjaftueshme për të justifikuar një masë të tillë drakoniane siç ishte



shkarkimi i menjëhershëm nga detyra. Kjo nuk kishte qenë një pasojë e parashikueshme për sjelljen e saj.

*ii. Qeveria*

113. Qeveria parashtroi se kërkuesja i ishte nënshtruar procesit të *vetting*-ut, i cili është ndryshe nga procedurat e zakonshme disiplinore. Shkarkimi i saj nga detyra kishte qenë proporcional, dhe mbështetur, *inter alia*, në faktin se ajo kishte deklaruar më shumë sesa dyfishi i asaj që ajo mund të provonte si pasuri e ligjshme sipas nenit D § 4 të Aneksit të Kushtetutës. Qëllimi kryesor i procesit të *vetting*-ut, sipas nenit D, ishte verifikimi i burimit të ligjshëm të pasurive dhe burimi i ligjshëm i të ardhurave. Detyrimi kryesor i kërkueses ishte të provonte burimin e ligjshëm të pasurive, gjë të cilën ajo nuk e kishte bërë në mënyrë të arsyeshme. Ajo nuk kishte kundërshtuar gjetjet paraprake të organeve të *vetting*-ut. Masa disiplinore e dhënë ndaj saj kishte qenë proporcionale me shkeljen e kryer prej saj.

**b) Vlerësimi i Gjykatës**

114. Një ndërhyrje në të drejtën për të respektuar jetën private do të konsiderohej “e nevojshme në një shoqëri demokratike” për një qëllim legjitim, nëse i përgjigjej “nevojës së ngutshme të shoqërisë” dhe, veçanërisht, nëse është proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur dhe nëse arsyet e paraqitura nga autoritetet vendëse për ta justifikuar atë janë “të duhurat dhe të mjaftueshme” (shih *Xboxhaj* cituar më sipër, § 402). E ndërsa u takonte autoriteteve vendëse që të bënin vlerësimin fillestar të nevojës, vlerësimi përfundimtar nëse arsyet e paraqitura për ndërhyrje janë të duhurat dhe të mjaftueshme mbetet objekt shqyrtimi nga Gjykata për përputhshmëri me kërkesat e Konventës (ibid.). Shkarkimi nga detyra është një sanksion i rëndë – ndoshta më i rëndi – disiplinor që mund të jepej ndaj një individi. Dhënia e një mase të tillë, e cila ndikon negativisht në jetën private të një individi, kërkon shqyrtimin e provave të forta në lidhje me etikën, integritetin dhe kompetencën profesionale të individit (ibid., § 403).

115. Siç përcaktohet në *Xboxhaj* (cituar më sipër, §§ 391-92 dhe 404), Ligji i *Vetting*-ut u përgjigjej nivele alarmante të korrupsionit në gjyqësor, siç vlerësohet nga qeverisja vendëse dhe vëzhgues të tjerë të pavarur, dhe nevojës urgjente për të luftuar korrupsionin, i cili ishte nënvizuar edhe në vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Për këtë arsye, Gjykata gjykante, se në rrethana të tilla, një reformë në sistemin e drejtësisë që sillte një *vetting* të jashtëzakonshëm për të gjithë gjyqtarët në detyrë, së bashku me prokurorët në detyrë, i përgjigjej një “nevoje urgjente të shoqërisë” (ibid., § 404).

116. Mbetet për t’u përcaktuar nëse autoritetet vendëse nuk morën parasysh margjinën e vlerësimit të shtetit përgjegjës kur vendosën të shkarkonin kërkuesen nga pozicioni i prokurores. Gjykata do të shqyrtojë nëse organet e *vetting*-ut kryen një vlerësim të individualizuar të arsyeve që çuan në shkarkimin nga detyra, më konkretisht për vlerësimin e pasurive. Fillimisht u takon autoriteteve vendëse, dhe qartazi gjykatave, që të interpretojnë ligjin vendës. Nëse interpretimi nuk është arbitrar apo qartazi i paarsyeshëm, roli i Gjykatës është i kufizuar në verifikimin e përputhshmërisë me Konventën për efektet e një interpretimi të tillë (shih *Radomilja dhe të Tjerët*, [GHM], cituar më sipër, §149 në kontekstin e nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës, dhe *Xboxhaj*, cituar më sipër, § 407 në kontekstin e nenit 8).

117. Gjykata thekson se mosrespektimi i detyrimeve nga ana e zyrtarëve publikë në lidhje me deklarin e pasurisë mund të konsiderohet në përgjithësi serioze. Ato mund të përfshijnë, midis të tjerash, mosdeklarimin e pasurive madhore ose burimet e të ardhurave apo përpjekjet e qëllimshme për t’i fshehur ato nga autoritetet; pamundësia për të justifikuar blerjet madhore me anë të kursimeve të ligjshme dhe të mjaftueshme, ose burimeve në kohën e përfutimit; ose një pamundësi për të justifikuar stilin e tepruar të jetesës, ose shpenzimet ekstravagante që është qartazi përtej mjeteve të deklaruara të ligjshme të zyrtarëve përkatës dhe familjes së tij. Gjithashtu, në lidhje me këtë aspekt,

Gjykata pranon se mund të jetë e ligjshme që të mbahen në konsideratë të ardhurat dhe deklaratimet e bashkëshortit/es të zyrtarit/es, partnerit/es apo pjesëtarëve të tjerë të familjes së ngushtë në vlerësimin e respektimit nga ana e zyrtarit të ligjeve kundër korrupsionit (shih *Samoylova kundër Rusisë*, nr. 49108/11, §§ 85-86, 14 dhjetor 2021). Në të njëjtën kohë, jo çdo rast i vogël i mosrespektimit të regjimeve të deklaratimit të pasurive, ose një mospërputhje e parëndësishme midis shpenzimeve dhe burimeve të ligjshme, duhet të nxisë sanksionet më të rënda disiplinore, të tilla shkarkimi nga detyra.

118. Duke u kthyer te çështja konkrete, Gjykata vëren se, pasi nisi hetimi për të tria kriteret dhe pasi u plotësua pjesa e kriterit të pasurisë, KPK-ja mbajti në konsideratë vlerën provuese të provave të mbledhura dhe vendosi të kufizojë vlerësimin në atë kriter. KPK-ja e kaloi barrën e provës të kërkujesja, e cila u njoftua se barra e provës kishte të bënte vetëm me vlerësimin e pasurive.

119. Në përputhje me Ligjin e *Vetting*-ut, kërkueses iu kërkuar të provonte burimet e ligjshme të përdorura për përfundimin e pasurive, dhe në thelb, faktin se ajo dhe familja e saj jetonin brenda mjeteve të tyre të ligjshme. Në linjë me angazhimet e Shqipërisë mbështetur në legjislacionin ndërkombëtar, kërkesa për të deklaruar pasuritë dhe për të provuar burimin e tyre të ligjshëm është parashikuar në ligjin vendës që prej vitit 2003, ku përshkruhen sanksionet për rastin kur nuk deklarohen pasuritë ose bëhen deklarime të rreme (shih *Xboxhaj*, cituar më sipër, §§ 201-04). Kjo është arsyeja se përse Ligji i *Vetting*-ut parashikonte përdorimin e deklaratimeve të mëparshme të pasurive si provë për të verifikuar vërtetësinë e deklaratimit të *vetting*-ut për pasuritë si provë për të verifikuar vërtetësinë e deklaratimit të *vetting*-ut për pasuritë; në çështjen konkrete kryesisht nga viti 2007 deri në 2011 në lidhje me pasuritë e përfuara dhe/ose të ardhurat e marra nga kërkujesja dhe bashkëshorti i saj nga viti 2008 deri në 2016.

120. Gjykata thekson gjetjen e KPK-së se pasuritë e deklaruara të kërkueses ishin më shumë sesa dyfishi i shumës së pasurisë së ligjshme, gjë e cila do të kishte sjellë shkarkimin e saj nga detyra sipas Nenit D § 4 të Aneksit të Kushtetutës. Kjo gjetje ishte rezultat i vlerësimit i të gjitha shpjegimeve dhe provave të paraqitura prej saj, dhe i të gjithë të dhënave të mbledhura gjatë hetimit dhe të vëna në dijeni të kërkueses. Sipas KPA-së, ai përfundim ishte pasoja logjike e arsyetimit në lidhje me secilën pasuri dhe i krahasimit midis shumës së pasurisë së mbledhur në vite dhe të deklaruar në deklaratimin e *vetting*-ut në vitin 2017, dhe i vlerësimit të ligjshmërisë së burimeve të të ardhurave. Personi i rivlerësuar duhej të shpjegonte në mënyrë bindëse burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurat dhe nuk mund të fshihte, apo të paraqiste në mënyrë të pasaktë pasuritë që zotëronte ose përdorte. Sipas nenit 4 të Ligjit të *Vetting*-ut, vendimi mund të bëhet mbështetur në një ose më shumë kritere ose me anë të një vlerësimi tërësor të të tria kriterëve. Parashikimet kushtetuese dhe parashikimet e tjera përkatëse parashikonin masat disiplinore edhe mbështetur në vetëm një kriter.

121. Në lidhje me pasurinë më të shtrenjtë (apartamenti me dy garazhe në Tiranë, i përfutur për 12,345,300 lekë), organet e *vetting*-ut gjykonin se kërkujesja nuk kishte provuar ligjshmërinë e pjesës thelbësore të burimeve të përdorura për përvetësimin e tij. Pas një rishqyrtimi të kujdesshëm të provave në dosjen e çështjes, KPA arriti në përfundimin se 4,749,349 lekë nuk mund të provoheshin se vinin në mënyrë të ligjshme nga kursimet familjare për periudhën 2007-11. KPA-ja kishte juridiksion mbi çështjet e faktit dhe ligjin, dhe kjo gjetje lidhej me aspektin tashmë të shqyrtuar nga KPK-ja, dhe vinte si rezultat i shkakut të apelimit të kërkueses në lidhje me qëndrimin e KPK-së për “dyshimin e tyre të arsyeshëm”, në lidhje me situatën reale të kursimeve. Vlerësimi për kursimet mbështetej në informacionet e marra nga deklaratimet vjetore të kërkueses. Në lidhje me vlerësimin e shpenzimeve për jetesën, KPA-ja specifikoi se u mbështet në të dhënat zyrtare të publikuara nga agjencia e statistikave për periudhën përkatëse. KPA-ja gjykoi, *inter alia*, se nuk ishte paraqitur asnjë provë e rëndësishme që të përkonte me periudhën kur pretendohet të ishin marrë paratë dhe përdorur për të përfutur prona të caktuara. Gjykata shprehet se vendimet vendëse nuk ishin arbitrare apo të pambështetura në fakte në lidhje me këtë aspekt.

122. Për më tepër, KPA-ja nuk ishte e bindur se kërkuesja kishte provuar burimin e ligjshëm të fondeve të përdorura për të përftuar një tjetër apartament dhe një njësi shërbimesh në Lezhë dhe për blerjen e makinës. Në një sërë rastesh, kërkuesja kërkonte të provonte ligjshmërinë e të ardhurave apo të transaksioneve me anë të provave dokumentare të marra vite më vonë, gjë që ngrinte pikëpyetje legjitime për integritetin e sjelljes së saj dhe gjykimin e saj të shëndoshë si prokurore.

123. Gjykata mund të pranojë se disa nga gjetjet e KPA-së rezultojnë të kenë qenë disi të ashpra ose formaliste, mbështetur në marrëdhëniet kryesor ndërpersonale dhe shkallën e informalitetit të transaksioneve që kishte ekzistuar në Shqipëri më herët gjatë tranzicionin demokratik. Ky është i njëjti rast, për shembull, me gjetjet e KPA-së, në lidhje me formalitetin e dhuratave të bëra nga vjehrra e kërkueses; deklarimi i dy garazheve që i përkisnin apartamentit në Tiranë, ose me shitjen e makinës së vjetër për 4,000 euro. Në të njëjtën kohë, është e qartë se ato pasuri apo transaksione përfshinin shuma disi të vogla, si në terma absolut edhe relativë. Në këtë mënyrë, Gjykata nuk mund të hedhë dyshime ndaj konstatimeve fillestare të KPA-së, në lidhje me parregullsitë e rënda ose mungesën e provave për disa nga pasuritë më të mëdha të kërkueses dhe të familjes së saj, të tilla si shumat e pajustificuara të kursimeve personale për periudhën 2007-11, mosdhënien e provave për pronësinë apo ndonjë dokument tjetër të vlefshëm për apartamentin e shembur në Lezhë, dhe huan jo substanciale prej 12,000 eurosh nga një mik.

124. Gjykata thekson se një situatë me informalitet të përgjithshëm në vend, edhe pse e kuptueshme në disa aspekte, nuk mund të përjashtojë faktin që një prokurore publike me eksperiencë – apo zyrtarë të tjerë në drejtësi – të përmbushë çështjet e saj me respektin më të madh për ligjshmërinë dhe në një mënyrë që është përtej kritikës publike; ata duhet të ruhen sipas standardit më të lartë etik. Gjithashtu, i ashtuquajturit “rregulli 200%” i siguronte kërkueses një liri veprimi të rëndësishme, në lidhje me vështirësitë objektive në provimin e ligjshmërisë së pasurive, disa prej të cilave ishin përftuar dikur në të shkuarën. Pavarësisht kësaj, ashtu siç përcaktohej nga autoritetet vendëse, kërkuesja nuk provonte në mënyrë bindëse ligjshmërinë as të 50% të pasurive të deklaruara.

125. Gjykata vëren se përfundimet e KPA-së si shkalla e fundit në procedurat e *vetting*-ut në lidhje me vlerësimin e pasurive, siç përshkruhet më sipër dhe marrë në mënyrë kulumative, ishin mjaftueshëm të rënda për të ngritur dyshime të rëndësishme për pasurinë financiare të kërkueses dhe për të justifikuar shkarkimin e saj nga detyra.

126. Gjykata vendos, duke marrë në konsideratë konstatimet e individualizuara të organeve të *vetting*-ut (shih paragrafët 15 dhe 20–22 më sipër), se shkarkimi i kërkueses nga detyra e saj si prokurore ishte proporcionale mbështetur në nenin 8 § 2 të Konventës. Ligji i *Vetting*-ut parashikonte dy lloje sanksionesh disiplinore: shkarkimin nga detyra ose pezullimin me detyrimin për të ndjekur trajnime të detyrueshme. Mungesa e një shkalle të duhur sanksionesh për shkeljet disiplinore mund të mospërputhet me parimin e proporcionalitetit (shih *Oleksandr Volkov kundër Ukrainës*, nr. 21722/11, § 182, GJEDNJ 2003). Legjislacioni i zbatueshëm parashikonte një hierarki më të detajuar sanksionesh disiplinore, që vendoseshin në përfundim të procedurave disiplinore të zakonshme (shih paragrafët 40 dhe 43 më sipër). Megjithatë, procedurat e *vetting*-ut kanë natyrë *sui generis*, pavarësisht ngjashmërive që ato duket se kanë me procedurat e zakonshme disiplinore. Ato ishin marrë si përgjigje ndaj pranisë së përhapur të korrupsionit në sistemin e drejtësisë për të zhdukur elementet korruptive dhe për të ruajtur pjesën e shëndetshme të sistemit. Gjykata u referohet konstatimeve të saj në *Xboxhaj* (cituar më sipër, § 412) se, duke marrë në konsideratë rrethanat e jashtëzakonshme, të cilat paraprinin hyrjen në fuqi të Ligjit të *Vetting*-ut, një shkallë më e kufizuar sanksionesh është me frymën e procesit të *vetting*-ut në rastin kur një person nuk përmbush një ose të tria kriteret e parashikuara në Ligjin e *Vetting*-ut.

#### 4. Përfundim

127. Gjykata arrin në përfundimin se procedurat e *vetting*-ut dhe shkarkimi i kërkueses nga detyra përputheshin me kërkesat e nenit 8 të Konventës.

128. Pas disa pasojave të caktuara në lidhje me konstatimet e bëra nga organet e *vetting*-ut dhe shkarkimit të kërkueses nga detyra, Gjykata më herët ka gjykuar se neni 8 i Konventës nuk mund të referohet për t'u ankuar për humbjen e reputacionit gjë që është pasojë e parashikueshme e veprimeve të një dikujt, si për shembull kryerja e një vepre penale ose ndonjë shkelje tjetër që sillte një masë me përgjegjësi ligjore me efekte negative që ishin të parashikueshme për “jetën private” (shih *Denisov kundër Ukrainës* [DHM], nr. 76639/11, § 98, 25 shtator 2018; shih edhe mbi disa kufizime të caktuara të atij parimi, *M.L. kundër Sllovakisë*, nr. 34159/17, §§ 38-39, 14 tetor 2021). Në çështjen konkrete, konstatimet e organeve të *vetting*-ut dhe shkarkimi i kërkueses nga detyra ishin rezultat i procedurave që përputheshin me kërkesat e nenit 6 dhe 8 të Konventës.

129. Në po të njëjtën mënyrë, Gjykata nuk anashkalonte faktin se sipas Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, shkarkimi i kërkueses nga detyra sillte ndalimin e përhershëm për të rihyrë në sistemin e drejtësisë. Duke qenë se ajo nuk dorëzoi një ankesë të veçantë pranë Gjykatës në lidhje me pasojën – që mësa duket ishte e drejtpërdrejtë dhe e pashmangshme – e shkarkimit të saj nga detyra në proceset e *vetting*-ut (shih paragrafët 83–84 më sipër), Gjykata përsërit se ajo ka marrë në konsideratë (shih *Xboxhaj* cituar më sipër, § 413) faktin se gjyqtarët, veçanërisht ata që mbajnë poste që sjellin nivel të lartë përgjegjësie, të tilla si postet në të cilat kërkuesi në atë çështje dëshironte që të rikthehej për të punuar, kishin një pjesë të pushtetit sovran të shtetit. Edhe në *Xboxhaj*, Gjykata deklaroi se ndalimi i përhershëm ndaj kërkuesit, një gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, dhe ndaj individëve të tjerë të shkarkuar nga detyra për shkelje të rënda etike, nuk ishte i papërputhshëm apo joproporcional me objektivin legjitim të ndjekur nga shteti – sipas kontekstit vendës për konsolidimin e shtetit të së drejtës në atë periudhë – për të garantuar integritetin e gjyqësorit dhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë (ibid.). Duke pasur parasysh statusin e prokurorëve në sistemin e drejtësisë në Shqipëri (shih paragrafët 36–38 më sipër), Gjykata vendos se aspekte të ngjashme detyruese zbatoheshin në lidhje me shkarkimin nga detyra e prokurorëve dhe ndalimin për të rihyrë në sistemin e drejtësisë (shih edhe paragrafët 51–57 më sipër).

130. Nuk është shkëlur neni 8 i Konventës për sa ka të bëjë me shkarkimin e kërkueses nga detyra.

### III. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 13 TË KONVENTËS

131. Kërkuesja u ankua se nuk kishte pasur një zgjidhje efektive, sipas nenit 13 të Konventës, në lidhje me ankesën e saj sipas nenit 8 për vendimin e KPK-së në çështjen e saj.

132. Neni 13 parashikon si më poshtë:

“Çdokush, të cilit i janë shkëlur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

133. Kërkuesja argumentoi se nuk i ishte dhënë një zgjidhje efektive për të kundërshtuar shkarkimin e paligjshëm, arbitrar dhe të dhënë para kohe. Ajo iu referua mangësive në procesin e *vetting*-ut dhe procedurave specifike të *vetting*-ut ndaj saj, veçanërisht përpara KPA-së. Gjithashtu, ajo iu referua pamundësisë për të depozituar një ankesë kushtetuese (neni A § 1 i aneksit të Kushtetutës).

134. Qeveria nuk ra dakord.

135. Për sa ka të bëjë me faktin se kërkuesja e ka lidhur ankesën e saj në mbështetje të nenit 13 me ankesat e saj procedurale (shih paragrafët 60–63 dhe 94 më sipër), pjesa civile e nenit 6 § 1 të Konventës është *lex specialis* (shih *Grzęda kundër Polonisë*, [DHM], nr. 43572/18, § 352, 15 mars 2022). Gjithashtu, duke pasur parasysh se ankesat sipas nenit 6 janë të papranueshme, Gjykata arrin në përfundimin se ky aspekt i ankesës, sipas nenit 13 duhet të rrëzohet si i papranueshëm.

136. Në lidhje me nenin 13 për ankesën sipas nenit 8 në kontekstin e procedurave të *vetting*-ut, kërkuesja depozitoi një apelim ndaj vendimit të KPK-së, i cili urdhëronte shkarkimin e saj nga detyra. KPA-ja, e cila kishte juridiksion të plotë ndaj çështjeve të faktit dhe ligjit, shqyrtoi meritat e apelimit të saj, duke përfshirë padrejtësinë dhe shpërpjesëtimin e shkarkimit të saj nga detyra. Fakti se KPA-ja e rrëzoi apelimin e saj nuk është mjaftueshëm për Gjykatën të vendosë se kjo nuk ishte një zgjidhje efektive (shih *Xboxhaj*, cituar më sipër, §§ 286 dhe 416). Në këto rrethana, Gjykata vendos se kjo pjesë e ankesës duhet të rrëzohet si e pambështetur në fakte në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) të Konventës.

#### PËR KËTO ARSYE, GJYKATA,

1. *E deklaron*, në mënyrë unanime, ankesën në mbështetje të nenit 8 të Konventës (në lidhje me shkarkimin nga detyra) të pranueshme;

2. *Deklaron*, me shumicë, pjesën tjetër të kërkesës të pranueshme;

3. *Vendos*, me gjashtë vota pro dhe një kundër, se nuk është shkelur neni 8 i Konventës.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 13 dhjetor 2022, sipas Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

**Milan Blaško**  
SEKRETAR

**Pere Pastor Vilanova**  
KRYETAR

Në mbështetje të nenit 45 § 2 të Konventës dhe Rregullit 74 § 2 të Rregullores së Gjykatës, opinioni i Gjyqtarit Serghides i është aneksuar këtij vendimi.

#### OPINIONI PJESËRISHT KUNDËRSHTUES I GJYQTARIT SERGHIDES

1. Unë jam dakord me paragrafin 1 të përcaktimeve operative të vendimit ku gjykohet se ankesa sipas nenit 8 të Konventës është e pranueshme.

2. Megjithatë, nuk bie dakord me paragrafin 2 të përcaktimeve operative të vendimit sipas së cilit pjesa tjetër e kërkesës është e pranueshme. Veçanërisht, jam i mendimit, se ankesa sipas nenit 6 të Konventës, jo vetëm që është e pranueshme, por është shkelur edhe ky nen, pasi procedurat e *vetting*-ut që vendosën për shkarkimin e kërkueses si prokurore nuk ishin të drejta sipas interpretimit të nenit 6 § 1. Gjithashtu nuk bie dakord me paragrafin 3 të përcaktimeve operative, ku gjykohet se nuk është shkelur neni 8 i Konventës.

3. Ky opinion merr formën e një deklarate ku nuk bihet dakord me vendimin (“thjesht një deklaratë mospajtimi”), në lidhje me paragrafët 2 dhe 3 të përcaktimeve operative (në lidhje me ankesat, sipas neneve 6 dhe 8 të Konventës, respektivisht) dhe për këtë arsye nuk merr formën e një opinionit të veçantë me të drejta të plota apo formën e një vote të thjeshtë anonime kundër këtyre paragrafëve. Një deklaratë mospajtimi me vendimin ose një pjesë të tij është një zgjidhje alternative e parashikuar nga Rregulli 74 § 2 i Rregullores së Gjykatës për gjyqtarët që dëshirojnë të shprehin mospajtim. Ky opinion është veçanërisht i përshtatshëm për mua në çështjen konkrete, pasi unë

tashmë kam shprehur këndvështrimet e mia edhe në dy kërkesa disi të ngjashme kundër Shqipërisë (shih, *mutatis mutandis*, qasjen time në opinionin kundërshtues në *Xboxhaj kundër Shqipërisë*, nr. 15227/19, 9 shkurt 2021, dhe opinionin tim pjesërisht pajtues dhe pjesërisht kundërshtues në *Besnik Cani kundër Shqipërisë*, nr. 37474/20, 4 tetor 2022 (ende jo i formës së prerë)).